



# Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

## Raport Vjetor

Janar - Dhjetor  
2023

## **RAPORT I PUNËS DHE I PËMBUSHJES SË DETYRAVE PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2023.**

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 ka zhvilluar një seri aktivitete të cilat mund të klasifikohen në aktivitete të rëndomta të funksionimit të IAL-së si dhe në aktivitete tjera të cilat kanë për qëllim përmbushjen e strategjisë së Universitetit të Prishtinës, përkatësisht të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit sikur janë organizimi i konferencës, bashkëpunimet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizimi i ligjëratave të hapura, tryezave të punës dhe të tjera.

Misioni i FIN-it është i bazuar në misionin e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e veprimeve akademike, hulumtimeve, punës shkencore dhe të krijojë kuadro profesionale të arsimit të lartë për tregun e punës për fushat e inxhinierisë së ndërtimit në pajtim me interesat strategjike dhe zhvillimore të vendit.

Për më saktësisht, Misioni i FIN-it është të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë dhe të transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore dhe po ashtu të ofrojë mundësi për të gjithë banorët e Kosovës për të përfituar nga ky arsim tërë jetësor pa kufizime.

Në këtë mënyrë, niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht transferuese në disiplina të përafërta.

Veprimtaria e njësisë sonë akademike, karakterizohet me bashkëveprimin në mes të veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore.

Aktivitetet kryesore të IAL-së fokusohen në:

- mësimdhënie - mësimnxënie,
- kërkime të vazhdueshme shkencore në shërbim të shoqërisë dhe vendit,
- zhvillim të kuadrove profesionalisht që janë kompatible me kërkesat e tregut,
- zhvillim të aktiviteteve në fusha të nevojshme për kërkesat e tregut,
- ofrime të shërbimeve dhe ekspertizave për palët e treta,
- hulumtime në zhvillimin e patentëve nga ana e personelit akademik.

Qëllimi i FIN-it është që të ketë rol udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë dhe gjithashtu të krijojë dhe të mbështes standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. FIN-i kërkon t'u përshtatet Standardeve Evropiane dhe të integrohet plotësisht në zonën Evropiane të arsimit të lartë sipas Deklaratës së Bolonjës.

Mësimdhënia dhe kërkimet shkencore, paraqesin veprimtarinë kryesore të kësaj njësie akademike. Veprimtarinë e një njësie akademike e karakterizon bashkëveprimi ndërmjet veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore. Kjo, për faktin se, për arritjen e rezultateve të dëshiruara në studime, mësimdhënia duhet të jetë e pa ndarë nga puna kërkimore shkencore.

Plani strategjik i zhvillimit të FIN-it për periudhën 2021-2023 si dhe Plani Strategjik i FIN-it 2024-2028 të miratuar nga Këshilli i Fakultetit dhe i publikuar në faqen elektronike <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,85> përcaktojnë qëllimet e arritjeve institucionale për periudhën e janar-dhjetor 2023, me prioritete:

- Rritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

- Përmirësimin dhe shtimin e rritjes së kapaciteteve të stafit akademik dhe ambienteve të mësimin.
- Rritjen e cilësisë për shërbimet e studentëve.
- Promovimin dhe rritjen e standardeve të cilësisë për programet e studimeve.
- Ngritjen e kapaciteteve të Laboratorëve për fushat profesionale shkencore.
- Avancimin e kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore në nivele ndërkombëtare.

Vizioni i **FIN**-it është:

- FIN të jetë një qendër e shquar e arsimit të inxhinierisë së ndërtimit në Kosovë duke u njohur ndërkombëtarisht për programet e studimeve, cilësinë e arsimimit dhe kontributin Institucional në zhvillimin e qëndrueshëm të fushës së inxhinierisë së ndërtimit.
- Shkalla e fleksibilitetit dhe shpejtësia e përshtatshmërisë së programeve të studimeve sipas nevojave dhe kërkesave të tregut të punës duke siguruar cilësi të lartë në të gjitha aktivitetet akademike, hulumtime, mësimdhënie si dhe shërbimeve tjera të kërkuara nga institucionet vendore.
- Punë kërkimore dhe akademike të mësimdhënësve dhe studentëve për të mbështetur procesin e mësimdhënies cilësore, vlerësimeve bashkëkohore, mësimnxënies, si procese të vazhdueshme Institucionale.
- Krijimi i kushteve dhe mundësive të pa penguar për zhvillimin dhe avancimin e aktiviteteve akademike për mësimdhënie të avancuar dhe hulumtime shkencore të stafit akademik.
- Angazhim aktiv i studentëve si në aspektin individual ashtu edhe kolektiv në jetën e aktiviteteve të Fakultetit, përkatësisht zhvillimit të programeve të studimeve dhe në mësimnxënien e tyre.
- Zhvillimi dhe avancimi i programeve të studimeve të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimit, përkatësisht të Konstruksioneve, Gjeodezisë, Hidroteknikës, Inxhinierisë së Ambientit dhe Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore, duke u mbështetur në arritjet shkencore dhe arsimore në Evropë dhe botë.
- Fokusimi evropian dhe ndërkombëtar në fushat e Inxhinierisë së ndërtimit, përkatësisht Konstruksioneve, Gjeodezisë, Hidroteknikës, Inxhinierisë së Ambientit dhe Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore, që t'i sigurojmë studentit dhe stafit akademik lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në kualifikimet dhe diplomat e arritura. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar të integrohem plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë.

Në këtë mënyrë niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht transferuese në disiplina të përafërta.

Sipas vendimit të FIN-it, nr 703 të datës 01 mars 2023 i propozohet Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për riemërimin, nga Fakulteti i Ndërtimtarisë në **Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit**. Ky riemërim është i bazuar thellësisht në fushat e studimeve si dhe nga programet e studimeve të cilat organizohen brenda njësisë tonë akademike të cilat i përkasin Inxhinierisë. Gjithashtu duke krahasuar edhe emërimet e IAL-ve të shkencave teknike brenda Universitetit tonë, Universiteteve Evropiane të cilat organizojnë studime të fushave të njëjta në vete kanë emrin me përmbajtje Inxhinieri, derisa në shkresa zyrtare të

komunikimit Fakulteti jonë në gjuhën Anglishte përdorë emrin *Faculty of Civil Engineering* që nënkupton Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Senati i Universitetit të Prishtinës me vendimin nr 728 të datës 27 mars 2023 miratoj propozimin për emërim dhe 27 mars 2023, njësisja jonë akademike quhet me emrin **Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)**.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit funksionon në mënyrë të organizuar sipas organogramës së treguar më poshtë.




Figura 1. Organogramma e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

Faqja elektronike e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit <https://fin.uni-pr.edu/> përditësohet dhe freskohet me informata aktuale në baza të rregullta kohore. Freskimi i publikimeve, informatave për gjithë spektrin e pedagogëve, studentëve, administratës dhe Bordin Industrial bëhet në kohë reale.

Në çdo vit akademik Fakulteti zgjedh dhe nominon studentët e dalluar për të cilët ndanë mirënjohje dhe se këta studentë publikohen në faqen elektronike të Fakultetit ndërsa në aktivitete të veçanta të njëjtët student janë me prioritet të zgjedhjes. <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,158>. Në 1 dhjetor 2023, është organizuar shpërndarja e mirënjohjeve “Student i Dalluar” e titulluar si ngjarje e ditës së parë të muajit të fundit për Studentët e rregullt nga dy nivelet e programeve të studimeve të FIN dhe u shpallën 22 Student të merituar me notë mesatare nga studimet mbi 9 (nëntë). Krahasuar me tri vitet e fundit, vërehet rritje e cilësisë në arritje të studentëve.




Figura 2. Diagrami i Studentëve të shkëlqyer në tre vitet e fundit.

Gjatë muajit maj, stafi dhe administrata e FIN-it është angazhuar për fushatë të sensibilizimit të maturantëve të shkollave të mesme në Kosovë. Janë organizuar takime për përgatitjen e materialeve njoftuese përkatësisht fletëpalosje me informata përmbajtjesore nga FIN-i dhe programet e studimeve të cilat organizohen nga IAL. Universiteti i Veror i Prishtinës i organizuar nga 03 deri 14 korrik 2023, konsiderohet si kontribuuese për sensibilizimin e maturantëve të rinj duke pas parasysh punëtorit dhe prezantimet e veçanta të njësive akademike në qytetin e Prishtinës. Me 11 korrik 2023 ishte prezantimi i FIN, Departamenteve, programeve të studimeve me pjesëmarrje masive nga mësimdhënësit, Administrata dhe Studentët në sheshin Xhorxh Bush.

Për mbarëvajtjen e mësimin në programet e studimeve dhe sipas kërkesës nga departamentet dhe miratimit të këshillit të FIN-it, në pajtim me rregulloret dhe vendimin e senatit angazhohen Profesorët Vizitor për vitin akademik 2023/2024 nga Universiteti Politeknik i Tiranës, përkatësisht Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Kolnit, dhe Universiteti i Maqedonisë së Veriut, sipas kësaj radhitje:

1. Prof.Dr. Neritan Shkodrani, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
2. Prof.Dr. Oltion Marku, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
3. Prof.Dr. Lars Ribbe, Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Institute for Technology and Resources Management in the Tropics and Subtropics (ITT), Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani.
4. Dr.Sc. Sudeh Denhavi, Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Institute for Technology and Resources Management in the Tropics and Subtropics (ITT), Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani.
5. Prof. Vlado Spiridonov, Universiteti “Kirily and Methody” Shkup, Maqedonia e Veriut.
6. Prof.asoc. Mimoza Hyseni Spahiu, Fakulteti i MTHM, Universiteti “Haxhi Zeka”, Pejë.

Profesorët vizitor sipas radhitjes, ju përgatiten kontratat sipas propozimit:

1. Prof.Dr. Neritan Shkodrani, kontrata për ngarkesë të plotë, edhe pse ngarkesa për semestrin dimëror është 13 orë ndërsa për semestrin veror është 12 orë, Fakulteti riorganizon ngarkesën në variantin që lëndët e drejtimeve të ndryshme mund të bëhen në një lëndë të vetme.

2. Prof.Dr. Oltion Marku, kontrata për ngarkesë në semestrin dimëror 8 orë ndërsa për semestrin veror është 4 orë.

Për mësimdhënësit – Profesor Vizitor (pozitat 3 deri 6) të ju bëhen kontratat sipas ngarkesës në tabela, mirëpo për angazhimin e tyre, Universiteti i Prishtinës nuk ka detyrime financiare pasi që kompensimi i tyre financiar bëhet nga mbështetësi i organizimit të programit të studimeve Master MIRU realizohet nga SKAT-i.

Si nevojë e madhe e punimeve shkencore të stafit akademik Fakulteti i Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës organizojnë konferencën e përbashkët ndërkombëtare të Inxhinierisë së Ndërtimeve në kohën 18 deri 20 maj 2023 në Tiranë <https://www.icce2023.al/>.

ICCE 2023, ishte konference e suksesshme e organizuar duke llogaritur mbi 250 pjesëmarrës, ndërsa ishin pjesëmarrës na 16 vende të ndryshme Evropiane dhe Botërore me përfaqësues nga Japonia, Italia, Gjermania, Austria, Polonia, Greqia, Turqia, Çekia, Portugalia, Danimarka, etj.. Në konferencë kontribuan nëntë ligjërues (Keynote) nga Japonia, Italia, Austria, Greqia, Polonia, Portugalia etj.. me tema nga fushat e Inxhinierisë së Ndërtimit. U pranuan 140 Abstrakte ndërsa ishin 100 punime nga të cilat 31 ishin nga stafi akademik i FIN-it.

Tabela 1. Lista e punimeve shkencore ne ICCE 2023 pjesë e stafit akademik të FIN.

Abstract ref. no.	Title	Authors
ICCE2023_SEE01	Nonlinear analysis of ground motion amplification for the case of Zagreb (Croatia) M5.5 Earthquake on 22 March 2020	<b>Adrian Kadiri</b> , Neritan Shkodrani
ICCE2023_SEE04	The advantages of designing residential buildings with the minimum height of floors allowed by standards	Ragip Behrami, Ilir Hetemi, Arton Qorri
ICCE2023_SEE05	Deviation effect on structure from Approved Layout Plan	<b>Florim Grajcevci</b> , Armend Mujaj, Egzon Ahmaxhekaj
ICCE2023_SEE07	SEISMIC PROTECTION OF BUILDINGS WITH TESTED UPGRADED SLIDING ISOLATION SYSTEM WITH SF DEVICES	Jelena RISTIC, Valon VESELI, Sergey CHURILOV, Danilo RISTIC
ICCE2023_SEE09	LOAD TESTING OF NEW BRIDGES	<b>Hajdar Sadiku</b> , Labeat Misini, Zijadin Guri, Ilir Canaj
ICCE2023_SEE14	Experimental Study on Steel Damper for passive energy dissipation	Franco Bontempi, Francesco Petrini, Ferit Gashi
ICCE2023_SEE15	Finite element modeling of retrofitted beam-column joint with FRP	<b>Naser Kabashi</b> , Milot Muhaxheri, <b>Enes Krasniqi</b> , Florentinë Latifi, Ylli Murati
ICCE2023_GE01	Geothermal piles a sustainable concept of alternative and renewable energy	Josif Josifovski, <b>Guxim Rrudhani</b>
ICCE2023_SEE16	Numerical Analysis of Extended End-Plate Bolted Connection with four bolts per horizontal row	<b>Anita Gjukaj</b> , Petar Cvetanovski, Ana Trombeva Gavriloska, <b>Ali Muriqi</b>
ICCE2023_SEE17	MASONRY BUILDING DESIGN IN ACCORDANCE OF THE EUROCODE STANDARDS, ANALYSIS OF THE BUILDINGS IN SEISMIC ZONES	Valentim Bajrami, Florim Grajcevci, Valon Veseli, Florim Istrefi
ICCE2023_SEE18	ANALYSIS AND TESTING OF COLUMNS REINFORCED WITH STEEL AND GFRP BARS	<b>Zijadin Guri</b> , Gjorgji Kokalanov, Danilo Ristić
ICCE2023_SEE19	Experimental and numerical Analysis of the steel columns under the axial load based on European Design Norms	<b>Armend Mujaj</b> , Florim Grajcevci, Driton Kryeziu, Ferit Gashi
ICCE2023_SEE20	Fire resistance analysis of one-way simply supported reinforced concrete slabs axially unrestraint and fully restraint	<b>Fidan Salihu</b> , <b>Fatos Pilana</b> , Meri Cvetkovska
ICCE2023_SEE24	Damage assessment and retrofitting strategies used in different low- and mid-rise buildings	<b>Arton D.Dautaj</b> , Markel Baballëku
ICCE2023_SEE25	Nonlinear modeling and design of the unreinforced masonry structures	Florim Grajcevci <sup>1</sup> , Agona Ramaj <sup>2</sup> , Fjolla Nicaj <sup>3</sup>
ICCE2023_SEE27	LAB-TESTS OF ORIGINAL AND UPGRADED RC FLOOR-BEAM AND COLUMN CONNECTIONS OF MODERN PRECAST HALL SYSTEM	<b>Labeat MISINI</b> , Jelena RISTIC, Viktor HRISTOVSKI, Danilo RISTIC
ICCE2023_SEE30	Comparison of different slabs in RC structure	<b>Cene Krasniqi</b> , Markel Baballëku, Enes Krasniqi
ICCE2023_CMCE06	Retrofitting of reinforced concrete column with externally bonded FRP mesh- Comparison and Numerical Methods	Vlorian Kaqi, Bledian Nela , Naser Kabashi
ICCE2023_CMCE07	Structural response of the masonry infilled reinforced concrete frames: A	Bledian Nela, Vlorian Kaqi, Naser

	numerical approach	Kabashi
ICCE2023_CTM01	Maintenance as a Tool to Avoid Defects in Sports Facilities: A Case Study of "Fadil Vokrri" Stadium in Prishtina	Nexhmi Krasniqi, Idaver Huseini, Besim Duraku, Anjeza Alaj
ICCE2023_CTM02	Quality management for design and built versus design bid build contracts for infrastructure projects	<b>Esat Gashi</b> , Marjan Ivezaj
ICCE2023_CTM03	Impact of Covid-19 in the Construction Sector in Kosovo: A post pandemic overview	Vlorian Kaqi, <b>Ilir Rodiqi</b>
ICCE2023_CTM04	Impact of delay completion of works to financial S-Curve – Railway rehabilitation project in Kosovo (Fushe Kosove-Hani i Elezit)	<b>Valon Veseli</b> , Esat Gashi, Vlorian Bublaku, Donika Xhakli
ICCE2023_CM01	Defects in concrete structures – Poor material quality or improper manufacturing	Florentinë Latifi, Agona Ramaj, Naser Kabashi, Florim Grajçevci
ICCE2023_CM05	Challenges in Hazardous Waste Management during Energy Efficiency Renovations: Case Study of Mitrovica	Nafije Gashi - Ademi, Vlerë Krasniqi, Luljeta Hoxha - Osmani
ICCE2023_CM06	Repair Principles for Corrosion-Damaged Reinforced Concrete Structures	Naser Kabashi, Mihrie Bajoku
ICCE2023_GE06	Geophysical surveys in order to determine the possibility of concentration of compact marbles in Syrigane locality, Skenderaj Municipality, Kosovo	<b>Islam Fejza</b> , Idriz Jata, Lavdim Osmanaj, Astrit Shala
ICCE2023_GE08	Soil improvement with geosynthetics in construction of railway track bed in weak soils – Rehabilitation of Kosovo Railway Route 10	<b>Guxim Rrudhani</b> , Esat Gashi, Isë Dakaj, Sylë Berisha
ICCE2023_HFWM04	Recent Trends of Several High and Low-Lands Rivers in Kosovo and Region	<b>Arban Berisha</b>
ICCE2023_HFWM05	Probable maximum flood analysis for the Radoniqi Reservoir	<b>Lavdim Osmanaj</b> , <b>Laura Kusari</b> , Venera Hajdari
ICCE2023_HFWM07	Transposition of the EU water directives into national legislation of Kosovo: the progress and challenges in implementation	Afrim Lajçi
ICCE2023_EQ02	Strategic Environmental Assessment: A Case Study of an Innovation and Training Park in Prizren	<b>Vlerë Krasniqi</b> , Nexhmi Krasniqi, Lumnije Gashi – Shabani
ICCE2023_WWT02	Selection of processes in decentralized treatment systems for special facilities	<b>Premton Thaqi</b> , Figene Ahmedi, Cenë Krasniqi
ICCE2023_CCA02	Engineered wetlands use case for climate change adaptation of vineyards in the Rahovec wine region of Kosovo.	<b>Dustin Sanchez</b> , Vlerë Krasniqi
ICCE2023_GCPRS02	Challenges and achievements over the years on the Department of Geodesy in Republic of Kosova	<b>Fitore BAJRAMI LUBISHTANI</b> , Milot LUBISHTANI
ICCE2023_GCPRS03	Generating 3D model for National Library of Kosovo using UAV technology	Agon Nimani, Behar Sallahu, Çlirim Podvorica, Albion Sertolli, Fisnik Loshi
ICCE2023_GCPRS06	State Coordinate Reference Systems of the Republic of Kosova and the Republic of North Macedonia in international EPSG and PROJ databases	<b>Bashkim Idrizi</b>
ICCE2023_GCPRS08	Assessing of UAVs technology for the documentation and preservation of cultural heritage buildings	<b>Almedina Rapuca</b> , Namik Kopliku
ICCE2023_NSIDI05	The use of elevation data in geospatial analysis	<b>Besim Ajvazi</b> , <b>Perparim Ameti</b> , Milaim Sylka
ICCE2023_TE04	Assessing the Impact of Atmospheric Conditions on Road Safety: A Study of the Radavc-Kulle Road	Fatbardha Ferataj, Nol Dedaj, Hazir Qadraku, Arjana Lajçi, Arlinda Cakaj, Muneeb Dar
ICCE2023_EQ06	Assessing the Potential of Lolium multiflorum and Trifolium pratense as Bioindicators of Heavy Metal Pollution	Arlinda Cakaj, Maria Drapikowska, Marta Lisiak-Zielińska, Annetta Hanć, Klaudia Borowiak, Kinga Drzewiecka, Arbnore Cakaj
ICCE2023_EGSM03	An overview of geodetic methods for the study of tall infrastructural objects	Artan Rexhepi, Lyubka Pashova, Bashkim Idrizi

Nga data 09 deri 11 tetor 2023, është organizuar Punëtoria në Podgoricë, Mali i zi, nga EPOS, seismology.

Pjesëmarrës në Punëtori ishin shumë institucione të rajonit, Evropës si dhe nga vende tjera të Botës. FIN ka marrë pjesë në punëtoritë dhe prezantimet lidhur me aspektet sizmike dhe efektet e tërmeteve në objekte ndërtimore. FIN do të jetë anëtar i konzorciumit të EPOS.



*Fotografia 1. Punëtorja EPOS-Tetor 2023.*

Në katër vitet e fundit, EFEHR ka bërë përparime të shquara në fushën e vlerësimit të rrezikut dhe kërcënimit sizmik në Evropë. Këto arritje tregojnë angazhimin e EFEHR për avancimin e kërkimit sizmik, qasjes në të dhënat dhe bashkëpunimit shkencor.

Së fundmi, janë shtatë partner të rinj që janë bashkuar EFEHR. Ata janë si pjesë e Asamblesë Gjenerale dhe pritet bashkëpunimin në të ardhmen.

- Departamenti i Ndërtimtarisë dhe Ndërtimtarisë Mjedisore, Imperial College London (Mbretëria e Bashkuar)
- Ndërtimtaria dhe Ndërtimtaria Mjedisore në Universitetin e Strathclyde (Mbretëria e Bashkuar)
- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (Kosovë)
- Institutit i Hidrometeorologjisë dhe Seismologjisë, Sektori i Seismologjisë (Mali i Zi)
- Departamenti i Strukturave për Inxhinieri dhe Arkitekturë të Universitetit të Naples Federico II, Naples (Itali)
- Fakulteti i Shkencave të Universitetit të Lisbonës, Instituto Dom Luiz IDL (Portugali)
- Departamenti i Ndërtimtarisë, TED University Ankara TED (Turqi)

Duke u mbështetur në Statutin e UP-së, mbi organizimin dhe funksionalizimin e Trupës Këshillëdhënëse (Bordit Industrial) të njëjve akademike, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit ndihmohet nga tregu i punës lidhur me informatat e kthyer nga persona të përkrahur të plasuar. Si nevojë e freskimit të Bordit Industrial të FIN-it janë zhvilluar negociata me shumë kompani vendore të cilat kanë shprehur gatishmëri të jenë pjesë e Bordit.

Gjatë periudhës së këtij raporti kryesia e BI mbanë takime në baza të rregullta mujore me FIN si dhe takime me BI në periudha gjashtëmujore. Së bashku me BI, FIN-ja organizon ligjërata të hapura, ndihmuan dhe mbështetën financiarisht mësimdhënësin me biletë udhëuese, mbështetën studentët me libra të paguara nga anëtarët e Bordit.

Me 16 qershor 2023, janë organizuar zgjedhjet e Kryetarit të BI të FIN-it, dhe është rizgjedhur për kryetar të BI për mandatin dy vjeçar z.Afrim Demiri, i.d.n. Në takimin e njëjtë është miratuar raporti dy vjeçar i punës së BI.

Nga data 19 deri 23 qershor 2023, janë organizuar takime pune me Shefat e Departamenteve, Stafin Akademik si dhe Administratën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit lidhur me diskutimet për Draft Statutin e Universitetit të Prishtinës. Në mënyrë zyrtare janë adresuar të



gjitha sugjerimet, rekomandimet dhe propozimet për Draft dokumentin tek Rektori i UP-së dhe grupi punues për hartimin e Statutit të Universitetit.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit brenda vitit hartoj katër propozime të projekteve hulumtuese. Nga të katër projektet u fituan:

- Projekti për monitorimin e ujit të pijes në Puset e Lipjanit, me vlerë prej 55,000.00 € i financuar nga SKAT-Kosovë.
- Projekti për monitorimin e reshjeve atmosferike, me vlerë prej 60,000.00 € i financuar nga SKAT-Kosovë.
- Projekti për Vlerësimin dhe Sanimin e Objekteve ekzistuese sistem me mure mbajtëse në Ulpianë, Prishtinë, 25,000.00 €i financuar nga Universiteti i Prishtinës.

Ndërsa projekti që nuk u klasifikua nga KUSA, është.

- USGP23/24 “FCE Alumni Association Web Platform”, në vlerë prej 50,000.00 € thirrje nga KUSA.

Gjatë vitit 2023, duke u mbështetur në projektet Erasmus + të arritura me Universitetet Evropiane janë zhvilluar mobilitete të Stafit akademik si dhe Studentëve.

- Memorandumi me Trento University është nënshkruar me 17.10.2023 ku parasheh: Mobilitetin e pesë Studenteve nga Fakulteti jone ne Trento qëndrim me një semestër. Mobilitetin e Stafit Akademike prej 4 personave me qëndrim prej 5 dite pune Mobilitetin e një Stafi Administrative prej 5 dite pune
- Memorandumi me BOKU University është fituar ne vitin 2023 dhe përfundon ne Qershore te 2024 ku parasheh: Mobilitetin për Stafit Akademike prej 60 dite pune nga këto dite 15 personeli Akademike: Lavdim Osmanaj, Premton Thaqi dhe Hanan Shehu kane qëndruar nga data 18.06.2023 deri 24.06.2023, mbeten edhe 45 dite tjera per tu shfrytëzuar ne vitin 2024.
- Memorandumi me Kolnin, Gjermani, janë zhvilluar tri mobilitete të mësimdhënësve nga Universiteti i Kolnit në Fakultetin tone: Prof.Lars Ribbe, Xhesika Hoxha dhe Sudeh Denhavi.

Me qëllim rritjen e cilësë në mësimdhënje dhe vlerësim bashkëkohor të Studentëve me 04 tetor 2023 u organizua punëtorja brenda FIN-it duke ftuar ligjërues nga Fakulteti i Edukimit të UP-së Prof.Majlinda Zhitija Gjellaj <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,6,775>, njohëse e fushave të vlerësimeve. Kjo punëtori i dedikohej stafit akademik të përfshirë në programet e studimeve të FIN-it dhe në fund të punëtorisë u përcaktuan prioritetet dhe rekomandimet të cilat edhe u miratuan në këshillin e Fakultetit. Rekomandimet dhe qëndrimet përmbajnë:

1. Prezenca e stafit akademik do të monitorohet dhe në çdo fund të muajit do të prezantohet para anëtareve të Këshillit të FIN.
2. I tërë stafi akademik obligohet që raportin e orëve të mbajtjes së mësimit të dorëzojnë në çdo fund të muajit te prodekani për çështje mësimore të FIN-t. Për çdo vonesë të dorëzimit të raportit të orëve të mbajtjes së mësimit mësimdhënësi do të sanksionohet pa të drejtën e arsyetimit ndaj sanksionimit të shqiptuar nga menaxhmenti i FIN-t
3. Për çdo afat të provimeve të dorëzohen raportet e kalueshmërisë tek prodekani për çështje mësimore.

4. Vlerësimi i vazhdueshëm - i detyruar sipas normave bashkëkohore të punës për secilin lëndë nga secili staf akademik.
5. Për studentët e rregullte të nivelit të studimeve Bsc dhe Msc nuk do organizohet afati i provimeve afati i nëntorit dhe afati i prillit, ndërsa për studentët absolvent të dy niveleve do ketë afate të provimeve (nëntor dhe prill) sipas rekomandimeve të nivelit qendror të UP-së.
6. Nga data 15 janar deri me 15 shkurt do organizohet fushat “Ditët e hapura“. Stafi akademik në koordinim me menaxhmentin e FIN do organizohen vizita në shkollat e mesme në nivel vendi.

Organizimi i takimeve kolegjiale, mbledhjet e këshillit të fakultetit të Ndërtimtarisë janë organizuar duke respektuar Statutit e Universitetit së paku një takim brenda një muaji. Takimet e komisionit të studimeve janë të rregullta dhe në funksion të kërkesave nga studentët. Takimet e Departamenteve me menaxhmentit të Fakultetit janë në funksion të kërkesave të tyre dhe me baza të rregullta. Gjithashtu, pjesëmarrja e Dekanit në takimet e kolegjiumit të Dekanëve dhe Senatit janë të rregullta. Takimet e menaxhmentit të Fakultetit me Bordin Industrial të Fakultetit janë të rregullta dhe periodike ne çdo muaj.

Konferenca e 20 Ndërkombëtare “XX Techincal Dam Control”, Safety Hydraulics Structures, 12-15 September 2023, Chorzow, Poland.

## 1. NGA BANKA E SHENIMEVE TE FIN

### 1.1 Numri i Studentëve

Numri i studentëve aktiv në Fakultet të Inxhinierisë së Ndërtimit për të gjitha programet e studimeve të niveleve BSc dhe MSc janë 1159, prej të cilëve 825 meshkuj dhe 334 femra.

Programet e studimeve Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi, Inxhinieri e Ambientit, Menaxhimi i Integruar i resurseve ujore përbëhen nga kurrikulat të formuara nga lëndë të përgjithshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale, plotësuese dhe temës së diplomës (Baçelor dhe/ose Master) e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.

Tabela 2 Numri i studentëve aktual në Programet e Studimeve

	Bachelor			Master			Total		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
Konstruksione	549	130	419	127	28	99	676	158	518
Hidroteknikë	110	21	89	56	30	26	166	51	115
Gjeodezi	178	46	132	62	25	37	240	71	169
Inxhinieri e Ambientit	74	51	23				74	51	23
Infrastruktura Rrugore				3	3	0	3	3	0
<b>TOTAL</b>	<b>911</b>	<b>248</b>	<b>663</b>	<b>248</b>	<b>86</b>	<b>162</b>	<b>1159</b>	<b>334</b>	<b>825</b>




Figura 1: Numri aktual i Studentëve në FIN për 2023

Numri i studentëve të ri për të studiuar në programet e studimeve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit është në rënje krahasuar me vitet paraprake, mirëpo duke falënderuar fushatat sensibilizuese të stafit të FIN në vitin 2023 ka një ruajtje të numrit të studentëve të rexhistruar me një rritje jo të madhe. Pranimi i studentëve të ri për vitin akademik 2023/2024 në të gjitha programet e studimeve në nivelin Bsc janë 148 student dhe programet e studimeve MSc janë 75 student. Kapaciteti i programeve të studimeve për studentë të ri në të gjitha programet e studimeve është 350 student, ndërsa të regjistruar për vitin akademik 2022/2023 janë gjithsej 223.




Figura 2. Numri i Studenteve ne FIN sipas Gjinive te pranuar ne vitin 2023.




Figura 3. Numri i studentëve të FIN-së të pranuar në pesë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve BSc




Figura 4. Numri i studentëve të FIN-së të pranuar në pesë vitet e kaluara për studime në programet e studimeve MSc

Për studentët e diplomuar, Alumni është krijuar bazë e shënimeve të tyre përmes pyetësorit të postuar në faqen elektronike të fakultetit dhe vazhdon edhe më tutje të plotësohet nga studentët e diplomuar. Ndërsa në vitin 2023 është hartuar projektpropozimi për realizimin e ALUMNI platformës nga satfi akademik dhe nuk jemi klasifiku në ofertën e KUSA. Ky projekt i studijuar dhe i konceptuar i trajtuar si i domosdoshëm për FIN do të jetësohet në mbështetje financiare nga donatorët në vitin 2024.

Janë disa raste të mobilitete të studentëve nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në institucionet Evropiane, sikur: Universiteti i Trentos, Itali; Universiteti Teknik i Vjenës – studime postdoktorale, Austri; “Poznan University of Life Sciences” Poloni; Universiteti i Gentit, Belgjikë. Ndërsa me interes për këtë raport pune të theksohet se një nga Studentet tona e diplomuar në programin e studimeve të Inxhinierisë së ambientit ka konkuruar për studime Master në 5 Universitete Evropiane dhe e që të gjitha e kanë ftuar të jetë studente e tyre.

Studentëve të Fakultetit ju është dhënë hapësirë në faqen elektronike të Fakultetit. Janë evidencat e Studentëve transparente të përfaqësimeve të studentëve nga Këshilli i Studentëve, përfaqësues të studentëve në Këshillin e Fakultetit, Studentët e dalluar, Puna e studentëve, Punimet e diplomave Master të Studentëve, etj.




Figura 5. Pasqyra tabelare e numrit te studenteve te FIN ne 10 vitet e fundit, si dhe numri i studenteve te ç' rexhistruar

## 1.2 Mësimdhënja akademike

Viti kalendarik 2023, karakterizohet me zhvillim të pa penguar të mësimin në semestrat veror dhe dimëror të viteve akademike (2022/2023 dhe 2023/2024) krahasuar me vitet paraprake kur mësimi ishte zhvilluar në variantin virtual duke marr parasysh efektin e pandemisë dhe infeksioneve të COVID-19.

Sipas shënimeve në SEMS dhe raportet e mësimdhënësve, mësimi për periudhën 15 shkurt deri 31 maj 2023 janë mbajtur gjithsej 4701<sup>h</sup>, që mesatarisht 68.37<sup>h</sup>/ditë pune. Ndërsa semestri dimëror fillon punën me mësim me 01 tetor dhe deri në dhjetor mësimdhënësit e FIN-së mbajtën 4630<sup>h</sup> mësim.

Tabela 3. Orët mësimore të mbajtura nga stafi akademik i rregullt, nga Universiteti dhe i angazhuar për semestrin dimëror të vitit akademik 2022/2023 për periudhën Janar-Maj 2023.

Orë mësimi të mbajtura nga stafi akademik, semestri veror 22/23						
Muaji	F1		F2	F3		F1+F2+F3
	BSc	MSc	BSc	BSc	MSc	
Shkurt	335	62	20	107	20	544
Mars	878	226	88	323	43	1558
Prill	692	178	36	229	36	1171
Maj	786	226	61	306	48	1430
<b>Totali</b>	<b>2691</b>	<b>692</b>	<b>205</b>	<b>965</b>	<b>148</b>	<b>4701</b>




Figura 6. Grafiku i mësimin të mbajtur në semestrin veror 22/23 sipas kategorisë së mësimdhënësit dhe muajve

Tabela 4. Orët mësimore të mbajtura nga stafi akademik i rregullt, nga Universiteti dhe i angazhuar për semestrin dimëror të vitit akademik 2023/2024 për periudhën tetor-dhjetor 2023.

Orë mësimi të mbajtura nga stafi akademik, semestri dimëror 23/24						
Muaji	F1		F2	F3		F1+F2+F3
	BSc	MSc	BSc	BSc	MSc	
Tetor	641	233	114	146	52	1186
Nentor	848	531	115	243	106	1843
Dhjetor	792	447	31	124	362	1756
Janar						
<b>Totali</b>	<b>2281</b>	<b>1211</b>	<b>260</b>	<b>513</b>	<b>520</b>	<b>4785</b>




Figura 7. Grafiku i mësimi të mbajtur në semestrin dimëror 23/24 sipas kategorisë së mësimdhënësit dhe muajve

### 1.3 Programet e Studimit

Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit organizohen programe të studimeve të niveleve BSc dhe MSc, ndërsa aktualisht nuk organizohen programe të Doktoratës. Programet e studimeve të klasifikuara të FIN-it në Departamente dhe nivele janë sikur:

- Konstruktiv (BSc), dhe (MSc)
- Hidroteknikë (BSc), (MSc)
- Gjeodezi (BSc), (MSc), dhe
- Inxhinieri e Ambientit (BSc)

Programet studimore Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit, në mënyrë të përgjithshme përbëhen nga grupi i lëndëve të përgjithshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale, plotësuese dhe punimi i temës së diplomës të nivelit Baçelor e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.

E veçantë e aktiviteteve të Fakultetit për këtë vit ishte përgaditja e programeve të studimeve për riakreditimit. Në këtë vit është akredituar programi i studimeve MSc në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore, sipas vendimit të Agjencisë për Akreditim të Kosovës përkatësisht KSHC-së në periudhën prej tri viteve. Programi i studimeve MSc në MIRU i takon departamentit të Hidroteknikës dhe zhvillohet në gjuhë Anglishte. Në shtator janë organizuar konkurset për pranimin e studentëve të ri dhe janë 20 kuota të cilat janë mbushur 100%. Mësimi ka filluar nga tetori 2023 pa asnjë pengesë dhe në semestrin dimëror 2023/2024 dhe janë organizuar mësimet edhe nga Profesorët Vizitor nga Gjermania, Universitetit i Kolnit si dhe Maqedonia e Veriut, Universiteti Kirili dhe Metodi. Ky program është vlerësuar me përqindje të lartë (96%) nga ekspertët e jashtëm të autorizuar për vlerësim të programeve të Studimeve nga AKA.

Dosjet e programeve të studimeve së bashku me RVV-të e tyre janë përgaditur për riakreditim si draft gjatë kohës mars - maj 2023 ndërsa janë përdyësuar në dhjetor të 2023. Për hartimin e RVV-ve dhe krijimin e dosjeve janë angazhuar stafi akademi, administrata si dhe studentët përmes grupeve punuese duke i përfshi edhe bartësit e programeve. Dosjet janë për programet e studimeve:

MSc Konstruktiv

MSc Hidroteknikë  
BSc Konstruktiv  
BSc Hidroteknikë.

Të gjitha Raportet e Vetëvlerësimit të Brendshëm për të gjitha programet e studimeve ishin të përgatitura nga stafi dhe studentët e FIN-it. Takimet me ekspertët e jashtëm për akreditimin e programit të studimeve MSc në MIRU u organizuan në një ditë 30 mars 2023. Janë shumë aktivitete paraprake të përgatitjeve të dosjes respektivisht të dokumentacionit për akreditimin e programit të studimit MSc në MIRU dhe veçanërisht kur ky program organizohet në gjuhë Anglishte, për të cilin stafi akademik i mbështetur nga administrata dhe i organizuar nga menaxhmenti dhe departamentet i Hidroteknikës dhe Inxhinierisë së Ambientit i kanë finalizuar me sukses, vlen të theksohet se shkalla e përqindjes së vlerësimit të RVV është 96%.

Me vendimin e Agjesionit të Akreditimit të Kosovës nr. 3020/21 të datës 12 gusht 2021, të gjitha programet e studimeve të FIN-së riakreditohen sipas kësaj radhitje dhe kohe:

- Programi i studimeve BSc Gjeodezi – 5 vite (21/22 deri në 25/26)
- Programi i studimeve BSc Konstruktiv – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve MSc Konstruktiv – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve BSc Hidroteknikë – 3 vite (21/22 deri në 23/24)
- Programi i studimeve MSc Hidroteknikë – 3 vite (21/22 deri në 23/24)

Ndërsa me vendimin e AAK-së nr. 941/22 të datës 18 korrik 2022, riakreditohen programet e studimeve për periudhën pesë vjeçare, sipas;

- Inxhinieria e Ambientit, BSc, 180 ECTS, 5 vite (22/23 deri 26/27)
- Gjeodezi, MSc, 120 ECTS, 5 vite (22/23 deri 26/27)

Me vendimin e AAK-së nr. 1003/23 të datës 26 korrik 2023, akreditohet programi i studimeve MSc Menaxhimi i Integruar i resurseve Ujore, 120 ECTS, në periudhën prej tri viteve (23/23 deri 25/26).

Për vitin e ardhshëm 2024 janë zhvilluar të gjitha përgatitjet e nevojshme për riakreditimin e programeve të studimeve BSc dhe MSc në Konstruktiv dhe Hidroteknikë.




Figura 8. Programet e studimeve të FIN-së të riakredituara nga viti 2021-2022

Kriteret – standardet e reja të Agjencionit të Akreditimit të Kosovës, përkatësisht Këshillit Shtetërorë të Cilësisë për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimeve do të jenë sfiduese për programet e organizuara nga FIN për periudhën e ardhshme të akreditimeve përkatësisht riakreditimeve. Brenda FIN-it organizohen 4 programe BSc dhe 4 programe MSc të studimeve.

Tabela 5 Akreditimet dhe Ri akreditimet e programeve studimore

Programet Studimore	Akreditimi i parë	Ri-akreditimi	Ri-akreditimi III	Ri-akreditimi IV +2 vite vazhdim Covid	Ri-akreditimi V
<b>BSc</b>					
Konstruktiv (BSc)	2009 - 2012	2012 - 2015	2015 - 2016	2016-2019 (+2vite)	2021-2024
Hidroteknikë (BSc)	2009 - 2012	2012 - 2015	2015 - 2016	2016-2019 (+2vite)	2021-2024
Gjeodezi (BSc)	2009 - 2012	2012 - 2015	2015 - 2016	2016-2019 (+2vite)	<b>2021-2026</b>
Inxhinieri e Ambientit (BSc)	2015 - 2018	2019-2022	<b>2022-2027</b>		
<b>MSc</b>					
Konstruktiv (MSc)	2009 - 2012	2012 - 2013	2014 - 2017	2017-2020	2021-2024
Hidroteknikë (MSc)	2009 - 2012	2012 - 2013	2014 - 2017	2017-2020	2021-2024
Gjeodezi (MSc)	2015 - 2018	2019-2022	<b>2022 - 2027</b>		
Infrastruktura Rrugore (MSc)	2011 - 2011	2012 - 2013	2014-2017		
MIRU - IWRM	<b>2023-2026</b>				

#### 1.4 Mësimdhënësit, përgjegjësit dhe ligjëratat e dhëna

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Fakultetit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programeve të studimeve.

Mekanizmat e mësimdhënies të cilat zbatohen në IAL-në janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë mëimit, përvojës të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të institucionit si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në zbërthimin e fenomeneve shkencore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, ndër të cilat "mësimdhënia një drejtimore" (nga pedagogu te studenti) duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies pedagogun e vejnë në rolin primar jo vetëm të profesorit mirëpo edhe të moderatorit.

Në fillim të vitit të ri akademik 2023/2024, 04 tetor 2023, menaxhmenti i FIN-it, në bashkëpunim edhe me ndihmën e Universitetit të Prishtinës, respektivisht me Fakultetin e Edukimit organizoj punëtorinë një ditore me titull “Metodat Bashkëkohore të mësimdhënjes dhe Vlerësimit të Vazhdueshëm për Studentët”

Stafi i Pedagogëve përgatitet gjithmonë me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies duke ju ofruar mundësia e pjesëmarrjes edhe nëpër trajnime permanente të ndryshme të



organizuar në nivel të Universitetit <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,78>. Vlenë të përmendet se një numër i konsiderueshëm i stafit akademik të rregullt janë trajnuar nga “Qendra për përsosmëri në mësimdhënje” e Universitetit të Prishtinës, “Hasan Prishtina”. Gjithashtu gjat vitit 2023 janë publikuar shumë oferta për trajnime të mësimdhënësve dhe studentve nga Institucion kombëtare dhe ndërkombëtare <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,41>.

Në funksion të formës së zgjedhur të mësimdhënies përcaktohet dhe organizimi i mësimdhënies, nëse ai do të jetë ligjërator, ushtrime numerike, mësim praktik në terren ose edhe ushtrime laboratorike. Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën mësimore. Rëndësi të veçantë ju jepet lëndëve të cilat ushtrojnë vizitat praktike në terrene si dhe ushtrimeve laboratorike duke demonstruar edhe shembuj praktik nga realiteti.

Veçori e Institucionit është monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimdhënësve gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Këtë monitorim e përcjellë vlerësimi i të gjithë mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit të vlerësuar nga studentët. Përmes instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies arrihet cilësia më e lartë e nxënies. Në vitin 2023 në FIN është punësuar dhe tani janë pjesë e Burimeve njerëzore; zyrtari për mësim (Arben Haliti) si dhe zyrtarja për shërbime të Studentëve Master (Albina Husaj Vishaj) të cilët ndihmojnë në zhvillimin e procesit të aktiviteteve akademike si dhe shërbimeve cilësore për studentët.

Secila lëndë mësimore ka literaturën e sajë themelore sipas syllabusit dhe literaturën e obliguar dhe të preferuar të cilën Studenti mund ta gjejë ose mësimdhënësi ju siguron paraprakisht.

Kurrikulat e programeve të studimeve si atyre themelore ashtu edhe studimeve master kanë koncept përmbajtësor duke pas për bazë parimet themelore të formimit të programit të studimit nga formimi i grupit të lëndëve të përgjithshme informuese, pastaj grupi i lëndëve teorike shkencore si dhe grupi i lëndëve përmbajtësorë të profesioneve të ngushta nga të cilat dalin edhe kompetencat e veçanta të studentëve pas përfundimit të studimeve.

Programi i studimit MSc në MIRU i cili është akredituar në korrik të 2023 dhe i cili zhvillohet në gjuhë angleze përmban një kurrikulë bashkëkohore duke u bazuar në disa programe të studimeve në Universitetet e Evropës, sikur Delf University në Holandë, Institute for Technology and Resources Management in the Tropics and Subtropics (ITT) Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Technology Arts Sciences TH Köln, University of Applied Sciences, ETH Zurich University etj. MSc në MIRU është mbështetur nga zyra Zviceriane në Prishtinë, respektivisht SKAT, në shumën prej 150.000,00 € duke shtuar investimet përkrahëse për dy projekte hulumtuese në vlerë prej 110.000,00 € si dhe mbulimi i shpenzimeve financiare për mësimdhënësit “Profesor Vizitor” nga Faculty of Spatial Development and Infrastructure Systems Technology Arts Sciences TH Köln, University of Applied Sciences, pastaj Universiteti Kirily and Methody, Shkup, Maqedonia e Veriut si dhe në përkrahje të shumë organizimeve të punëtorive me institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare. Programi i studimit është në rrjedhë të punës, ku planifikohen shumë aktivitete për studentët duke pas fokus të veçantë zhvillimin e praktikave në institucione Evropiane.

Sfidë për programet e studimeve të FIN-it është avansimi i stafit akademik me tituj shkencore dhe grada akademike, prandaj viti 2023 karakterizohet me tre prurje të reja të stafit akademik – asistent si dhe avansimin e katër asistentëve në profesor asistent si dhe avansimin e një mësimit nga Prof. i asocuar në Profesor i plotë. Këto avansime përmirësojnë mësimit dhe krijojnë mundësi më të mëdha të zhvillimit akademik të njësisë tonë.

Gjatë vitit 2023 janë riorganizuar monitorime të procesit të mësimit, duke vlerësuar në kohë reale përfshirjen e mësimit përmes dëshmive të raporteve të stafit akademik në rexhistruar në platformën SEMS si dhe listat fizike të studentëve në procesin mësues si dhe prezencën në Fakultet. Raporti i mbajtjes së mësimit, prezencës në Fakultet si dhe raporti i provimeve të mbajtura për studentët shfaqen në mbledhje të rregullta të këshillit të FIN. Raportet krijojnë pasqyrë reale të angazhimeve dhe suksesit, duke vlerësuar cilësinë e mësimit në aspektin kuantitativ si dhe duke vlerësuar kalueshmërinë e studentëve në aspektin cilësor. Nga këto raporte nxirren konkluzione për hapat e ardhshëm të veprimit.

Në të dy semestrat (veror dhe dimëror) mësimit regjistruan përqindjen më të madhe të orëve të mësimit të mbajtur në platformën SEMS 9486 orë mësimi, nërsa përqindje e vogël e raporteve tregojnë për regjistrimin e mësimit me lista fizike (duke arsyetuar raportet e regjistruara si mungesë e energjisë elektrike, mos funksionimit të rexhistruesve apo zhvillimit të praktikave në terren).

Pjesa dërmuese e mësimit përdorin platformën e google clasroom për komunikim me studentët duke ju shpërndarë materialet e nevojshme për lëndët, komunikimin mbi arritshmërinë e vlerësimeve të vazhdueshme si dhe informatave tjera të nevojshme dhe të domosdoshme për studentët.

### **1.5 Vlerësimi i vazhdueshëm, provimet dhe punimet seminarike**

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka rolin kryesor mësimit dhe mësimit, ku gjatë gjithë kohës ka në qendër të vëmendjes studentin. Përsosja e mësimit arrihet përmes punës kërkimore hulumtuese që realizohet nga personeli akademik i IAL-së. Angazhimi i personelit akademik në fushat e hulumtimeve është prezent jo vetëm në vend, mirëpo edhe jashtë vendit duke dhënë kontribut shkencorë në konferenca shkencore me punime shkencore të publikuara edhe në revistat më prestigjioze në botë të fushës.

Në vitin 2023 janë organizuar provimet e studenteve në afatet e rregullta të janarit, qershorit dhe shtatorit. Duke pas parasysh vendimin e Senatit mbi organizimin e afateve shtesë të provimeve me studentët janë organizuar edhe afatin e prillit.

Analizat e arritjeve të rezultateve të studentëve në afatin e prillit tregojnë vlera të vogla ndërsa gjatë kësaj periudhe të organizimit të provimeve në këtë afat pjesëmarrja e studentëve në mësimit kishte rënje të konsiderueshme duke rrezikuar në masë të madhe humbjen e vitit. Dëshmitë për arritje të vogël të studentëve në provime gjatë vitit janë treguesit sikur në tabelën vijuese:



### Kalueshmëria e studentëve




Figura 9. Pasqyra e rezultateve te arritshmerise se studenteve ne provime sipas viteve.

Si shkas i përqindjes së vogël të arritjeve të studentëve në provimet – programet e studimeve, janë realizuar analiza të sintetizuara për gjetje, duke insistuar në reformimin e proceseve të mësimdhënjes si dhe vlerësimeve të vazhdueshme të studentëve.

Punëtorja e organizuar në fillim të vitit akademik 2023 nga FIN, mësimdhënja bashkëkohore dhe vlerësimi i vazhdueshëm kishte synim reformimin e mësimi, organizimit të provimeve, vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve duke pas synimin kryesor **ruajtjen e cilësisë** përmes punës dhe angazhimit të shtuar të stafit akademik, duke organizuar kolokiume, testime gjatë semestrit, vlerësime të punës semestrale, vlerësime të prezencës në mësim të studentëve si dhe aktivitete tjera të matshme për punën e studentëve gjatë semestrit. Punëtorja kishte synim përfshirjen e të gjithë stafit akademik në procesin mësimor në programet e IAL-së duke përfshi stafin e rregullt, të ftuar dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Pjesëmarrja në punëtori ishte në përqindje të madhe.



Fotografia 2: Punëtorja “Mësimdhënja bashkëkohore dhe vlerësimi i vazhdueshëm”

Nga matjet e realizuara me studentët nga përgjegjësit, pjesa dërmuese e mësimdhënësve në lëndët mësimore janë duke e praktikuar vlerësimin e vazhdueshëm ndërsa do të realizohen matje të arritjeve të studentëve në afatet e provimeve vijuese. Si rezultat i punës së organizuar me stafin akademik për vlerësimin e vazhdueshëm, afati jo i rregullt i provimeve të nëntorit 2023 është organizuar brenda një dite me qëllim që të mos cenohet procesi mësimor si dhe arritjet e studentëve në përmbushjen e detyrimeve nga mësimi.

Nga raportet e rezultateve të studentëve të nënshtruara në provime bëhen analiza të sintetizuara për afatet e rregullta të kalueshmërisë si element i cilësisë. Analiza e Raporteve të kalueshmërisë analizohet në nivel të Këshillit të Fakultetit.

Gjatë gjithë kohës së mësimave në semestër në lëndët inxhinierike punohen projekte semestrale të cilat vlerësohen nga mësimdhënësit – asistentët dhe vlerat e arritura nga puna semestrale e studentëve vlerësohet në provimin përfundimtarë. Në shumë nga lëndët

mësimore organizohen kolokiume (dy ose tre, në varësi të lëndës dhe metodologjisë së mësimdhënësit) gjat semestrit.

E veçantë e vitit 2023 konsiderohet përfshirja e studentëve në punët e angazhimeve të IAL-së me Institucionet e vendit. Vlenë të përmenden përfshirja e studentëve në vlerësimet dhe analizat për objektin e teatrit kombëtar, ura në Rogovë – Gjakovë, KRU Prishtina, AI Trade etj.

## 1.6 Diplomat

Numri i të diplomuarve sipas statistikave të SEMS-it për Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit sipas departamenteve, përkatësisht programeve të studimeve për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor të vitit 2023 janë:

Tabela 6: numri i studentëve të diplomuar në nivelin Baçelor të studimeve për vitin 2023

nr	Programi i studimeve – Baçelor	Numri i te diplomarëve
1	Konstruktiv	43
2	Hidroteknikë	18
3	Gjeodezi	21
4	Inxhinieri e Ambientit	15
	<b>Total</b>	<b>97</b>




Figura 10: studentët e diplomuar në BSc dhe MSc FIN për vitin 2023.

Tabela 7: numri i studentëve të diplomuar në nivelin Master të studimeve për vitin 2023

nr	Programi i studimeve – Master	Numri i te diplomarëve
1	Konstruktiv	12
2	Hidroteknikë	13
3	Gjeodezi	2
4	Infrastrukturë Rrugore	2
5	MIRU	0
	<b>Total</b>	<b>35</b>

Procedurat e organizimit të diplomave në nivelet BSc dhe MSc janë në përputhje sipas rregulloreve përkatëse të studimeve.

Sipas programeve të studimeve dhe viteve të kaluara, në tabelën vijuese janë treguar numri i studentëve të diplomuar në periudhën 5 vjeçare (01 janar 2019 deri 31 dhjetor 2023).

Tabela 8: Numri i Studentëve të diplomuar në BSc nga viti në vit, nga 2019 deri 2023

Programi i Studimit	2023 – janar dhjetor			2022 – janar dhjetor			2021 – janar dhjetor			2020 - janar dhjetor			2019 – janar dhjetor			Gjithsej		
	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ
Konstruktiv	7	36	43	10	36	46	14	54	68	12	47	59	14	58	72	57	231	288
Gjeodezi	5	16	21	5	32	37	7	27	34	10	24	34	20	43	63	47	142	189
Hidroteknikë	1	17	18	11	17	28	7	17	24	5	9	14	13	19	32	37	79	116
Inxhinieri e Ambientit	12	3	15	15	5	20	15	5	20	10	1	11	6	1	7	58	15	73
GJITHSEJ	25	72	97	41	90	131	43	103	146	37	81	118	53	121	174	199	467	666




Figura 11. Numri i Studentëve të diplomuar në BSc në vitet 2019 deri 2023

Ndërsa në programet e studimeve Master, në 5 vitet e fundit numri i Studentëve të diplomuar janë sikur në tabelën në vazhdim.

Tabela 9: Numri i Studentëve të diplomuar në MSc nga viti në vit, nga 2019 deri 2023

Programi i Studimit	2023 – janar dhjetor			2022 – janar dhjetor			2021 – janar dhjetor			2020 – janar dhjetor			2019 – janar dhjetor			Gjithsej		
	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ	F	M	GJ
Konstruktiv	4	9	13	7	12	19	2	12	14	1	18	19	4	9	13	18	60	78
Hidroteknikë	3	9	12	2	9	11	5	3	8	4	3	7	1	2	3	15	26	41
Gjeodezi	1	1	2	0	1	1	1	4	5	1	1	2	0	1	1	1	8	11
Infrastruktura rrugore	2	0	2	0	1	1	0	0	0	0	3	3	0	1	1	2	5	7
<b>GJITHSEJ</b>	<b>10</b>	<b>18</b>	<b>29</b>	<b>9</b>	<b>23</b>	<b>32</b>	<b>8</b>	<b>19</b>	<b>27</b>	<b>6</b>	<b>25</b>	<b>31</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>18</b>	<b>38</b>	<b>99</b>	<b>137</b>




Figura 12. Numri i Studentëve të diplomuar në MSc në vitet 2019 deri 2023

Numri i studentëve të cilët kanë braktisur studimet nga programet e studimeve në FIN për vitin 2023 në bazë të evidencës janë 17 (15 nga BSc dhe 2 nga MSc).

### 1.7 Rezultatet e vlerësimit të studentëve

Sipas statistikave të provimeve të organizuara në afatet e rregullta të janarit, qershorit dhe shtatorit 2023, pas analizës dhe diskutimit të vlerave të arritura të vlerësimeve në mbledhjet e këshillit të Fakultetit në vazhdim paraqiten në mënyrë të sintetizuar tabelare dhe grafike.

Tabela 10: Statistikë e rezultateve të aritjes në provime të Studentëve BSc në afatin e provimeve janar 2023

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	586	98	274	56.15	214	43.85
2	Hidroteknikë	116	41	37	56.92	28	43.08
3	Gjeodezi	399	106	103	35.15	190	64.85
4	Inxhinieri e Amb.	133	23	80	75.45	27	24.55
	<b>Totali</b>	<b>1234</b>	<b>268</b>	<b>494</b>	<b>55.92</b>	<b>459</b>	<b>44.08</b>

Tabela 11: Statistikë e rezultateve të aritjes në provime të Studentëve MSc në afatin e provimeve janar 2023

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	89	29	40	68.33	19	31.67
2	Hidroteknikë	70	11	25	42.37	34	57.63
3	Gjeodezi	38	6	19	62.5	12	37.5
	<b>Totali</b>	<b>197</b>	<b>46</b>	<b>84</b>	<b>57.73</b>	<b>65</b>	<b>42.27</b>




Figura 13. Kalueshmëria e Studentëve BSc dhe MSc në afatine provimeve të Janarit 2023

Në nivel të Fakultetit, kalueshmëria e studentëve në provime, në afatin e rregullt të Janarit 2023 është, 56.69%. Në provime janë paraqitur gjithësej 1431 student, të abstenuar 314 (21.95%).

Tabela 12: Statistikë e rezultateve të aritjes në provime të Studentëve BSc në afatin e provimeve qershor 2023

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	514	72	220	50.90	217	49.10
2	Hidroteknikë	99	37	49	80.65	12	19.35
3	Gjeodezi	388	208	114	63.33	66	36.67
4	Inxhinieri e Amb.	167	47	104	90.00	12	10.00
	<b>Totali</b>	<b>1168</b>	<b>364</b>	<b>487</b>	<b>71.22</b>	<b>307</b>	<b>28.78</b>

Tabela 13: Statistikë e rezultateve të aritjes në provime të Studentëve MSc në afatin e provimeve qershor 2023

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	64	16	39	81.25	9	18.75
2	Hidroteknikë	45	22	23	100.0	0	0.00
3	Gjeodezi	107	81	21	80.77	5	19.23
	<b>Totali</b>	<b>216</b>	<b>119</b>	<b>83</b>	<b>87.34</b>	<b>14</b>	<b>12.66</b>



Figura 14. Kalueshmëria e Studentëve BSc dhe MSc në afatin e provimeve të qershor 2023

Në nivel të Fakultetit, kalueshmëria e studentëve në provime, në afatin e rregullt të qershorit 2023 është, 78.13%. Në provime janë paraqitur gjithësej 1384 student, të abstenuar 483 (34.90%).

Tabela 14: Statistikë e rezultateve të aaritjes në provime të Studentëve BSc në afatin e provimeve shtator 2023

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	487	154	161	48.95	170	51.05
2	Hidroteknikë	39	16	13	56.52	10	43.48
3	Gjeodezi	369	83	93	32.52	193	67.48
4	Inxhinieri e Amb.	65	22	30	72.09	12	27.91
	<b>Totali</b>	<b>960</b>	<b>275</b>	<b>297</b>	<b>52.52</b>	<b>385</b>	<b>47.48</b>

Tabela 15: Statistikë e rezultateve të aaritjes në provime të Studentëve MSc në afatin e provimeve shtator 2023

nr	Departamenti	Paraqitja	Abstenua	Kaluan Provimin	%	Nuk kaluan provimi	%
1	Konstruktiv	62	21	35	87.80	5	12.20
2	Hidroteknikë	48	32	6	37.50	10	62.50
3	Gjeodezi	84	53	28	93.55	2	6.45
	<b>Totali</b>	<b>194</b>	<b>106</b>	<b>69</b>	<b>72.95</b>	<b>17</b>	<b>27.05</b>




Figura 15. Kalueshmëria e Studentëve MSc dhe BSc në afatin e provimeve të shtatorit 2023

Në nivel të Fakultetit, kalueshmëria e studentëve në provime, në afatin e rregullt të shtatorit 2023 është, 61.28%. Në provime janë paraqitur gjithësej 1154 student, të abstenuar 381 (33.02%).

Në mënyrë analoge sintetizohen pasqyrat e arritshmërive në afatet e rregullta të provimeve në nivel të Fakultetit. Këto vlera diskutohen në nivel të këshillit të Fakultetit.

## 2. KËRKIMET SHKENCORE

Personeli akademik i FIN-it jep kontribut të çmuar për shërbime të ndryshme të Fakultetit sipas kërkesave dhe mund të numërohen disa nga këto punë, sikur janë: Raporti i vlerësimit të programeve të studimeve, hartimi i raporteve dhe analizave të ndryshme për nevojat e fakultetit etj. Prandaj, menaxhmetni i FIN së bashku me stafin akademik dhe administratën janë të angazhuar jo vetëm në procesin e mësimit, mirëpo edhe në ngritjen e performancave të mësimit, mësimit, hulumtimeve shkencore dhe shërbimeve tjera të nevojshme për Institucionin.

Projektet shkencore të fituara në vitin 2023:

**1. “Monitorimi i cilësisë së ujërave dhe monitorimit të ujit të puseve në pjesën perëndimore të Komunës së Lipjanit”,** ky projekt ka startuar me datën 06.03.2023 ku do të bëje monitorimin e cilësisë dhe sasisë së ujërave deri me 06.03. 2024.

Qëllimi kryesor i këtij projekti hulumtues është që përmes pasjeve që janë instaluar në 7 (shate) puse të kemi të dhëna në kohë reale për cilësinë dhe sasinë e ujit, si dhe përcaktimin e zonave mbrojtëse ujore (zona parë, zona dytë, zona tretë), zona që do të përcaktohen me modelime matematike e pastaj me ane të softverit Madflow. Nga ky hulumtim parashihet të publikohen dy punime shkencore si dhe pjesëmarrja e një konference, po ashtu edhe dy tema në nivelin Msc.

Në këtë projekt hulumtues janë të përfshira të gjitha institucionet që i atakon ky projekt si: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, K.R.U. “Prishtina”, Komuna e Lipjanit, si dhe Studentet.

Pas përfundimit me 06.03. 2024, pasjet do të zhvendosen në një zonë tjetër ujëmbajtëse të ujërave nëntokësor, në bashkëpunim me gjithë akteret e lartcekur.

**2. “Monitorimi i parametrave Meteorologjik në nëntë zonat e Kosovës”,** ky projekt hulumtues ka startuar me 22. 08.2023 dhe është duke vazhduar, deri me tani janë instaluar të gjitha pasjet (nëntë) në shtat Kompanitë Rajonale si dhe një në Komunën e Lipjanit dhe Vushtrisë.

Qëllimi kryesor i këtij projekti Hulumtues që të grumbulloje të dhëna të mjaftueshme sa i përket parametrave baze meteorologjik si të dhënat për: reshjet, temperaturat, erën, ajri, evopostspiracioni, radiocioni etj. Po ashtu vlen të ceket se është zhvilluar një platforme ku të dhënat regjistruar çdo një minute dhe ruhen në domenin e fakultetit tone.

Nga ky hulumtim parashihet të publikohen tri punime shkencore si dhe pjesëmarrja e një konference, po ashtu edhe katër tema në nivelin Msc.

Në këtë projekt hulumtues janë të përfshira të gjitha institucionet që i atakon ky projekt si: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, shtate Kompanitë Rajonale, si dhe Studentet.

**3. Vlerësimi dhe Sanimi i objekteve të banimit në zonën Ulpiana të Prishtinës.** I financuar nga Universiteti i Prishtinës.

Projekti synon të vlerësojë dhe përmirësojë qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e strukturave ndaj rreziqeve natyrore gjegjësisht tërmeteve. Përforsimi i strukturave bazohet në aplikimin e



kodeve të inxhinierisë së ndërtimit, duke siguruar zbatimin e metodologjive dhe standardeve relevante. Gjithashtu, projekti synon të rrisë nivelin e hulumtimit në Inxhinierinë e Ndërtimit, me fokus në përmirësimin e praktikave inxhinierike dhe zhvillimin e njohurive për mbrojtjen kundër tërmeteve.

Pikat kyçe të projektit përmirësojnë qëndrueshmërinë e strukturave, sigurinë sismike dhe praktikatat inxhinierike. Ndikimi i tij në ndërtimet ekzistuese ka potencial për të afektuar pozitivisht në jetën dhe sigurinë e banorëve. Përmes zbatimit të metodave të avancuara dhe kodeve të fundit, projekti synon të përdorë njohuritë e fituara për të rritur standardet e inxhinierisë së ndërtimit dhe mobilizuar resurset për përmirësimin e ndërtimeve.

Rezultatet e projektit pritet të japin një kontribut të rëndësishëm në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit, duke adresuar sfidat e sigurisë sismike. Përmes prezantimeve në konferenca ndërkombëtare dhe publikimeve shkencore, synohet ndarja e njohurive me komunitetin shkencor dhe profesionistët e fushës. Projekti shikon përtej kufijve të vendit dhe synon të kontribuojë në diskutimet globale për mbrojtjen dhe përmirësimin e ndërtimeve ekzistuese ndaj rreziqeve nga tërmetet, duke u bërë një kërkesë e domosdoshme për zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurtë të infrastrukturës së ndërtesave në kohët moderne.

## **2.1 Artikujt e botuar shkencor, monografitë dhe botimet tjera shkencore**

Si nevojë e madhe e punimeve shkencore të stafit akademik Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës organizojnë konferencën e përbashkët Studentore Ndërkombëtare të Inxhinierisë së Ndërtimeve ISCCE 2024 në kohën 25 deri 27 prill 2023 në Prishtinë <https://www.iscce.uni-pr.ed>

Nga nëntori i vitit 2023 janë zhvilluar shumë takime në mes të menaxhmenteve të dy IAL-ve me qëllim të krijimit të trupave të domosdoshme të konferencës. Janë themeluar; komiteti këshillëdhënës ndërkombëtar i ISCCE2024, komiteti organizativ i ISCCE 2024, komiteti shkencor i konferencës si dhe janë përcaktuar numrat e Keynote speakers.

Konferenca është vazhdim i konferencës së parë studentore të organizuar në Tiranë e organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit-Tiranë dhe Fakulteti i Ndërtimtarisë-Prishtinë dhe është konceptuar që të shndërrohet në një ngjarje të rëndësishme, si shkencore ashtu edhe kulturore.

Sesionet e ndryshme të konferencës do të fokusohen në tematikë me interes dhe që kanë një impakt të rëndësishëm në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Këto tematika përfshijnë inxhinierinë e strukturave, inxhinierinë e trafikut dhe të transportit, menaxhimin dhe teknologjinë e ndërtimit, inxhinierinë gjeoteknike, inxhinierinë e tërmeteve, inxhinierinë hidraulike, hidrologjinë, menaxhimin e përmytjeve dhe ujit, inxhinierinë e strukturave hidraulike dhe detare, inxhinierinë e mjedisit, trajtimin e ujit dhe mbetjeve, efiqensën e energjisë dhe energjitë e rinovueshme, inxhinierinë gjeodezike, hartografinë, fotogrametrinë, si dhe trajtimin e ndërtimeve historike dhe monumentale.

Takimi teknik i fundit në mes të dy IAL-ve u organizuara në 19 dhe 20 dhjetor 2023 nga i cili takim dolën çështje organizative të cilat do të zgjedhjen në vazhdueshmëri lidhur me konferencën studentore ISCCE 2024. U diskutua dhe u vendos për afatin e dorëzimit të abstrakteve si dhe punimeve shkencore, publikimeve të konferencës, marketingut, mbështetjes financiare, sesioneve të veçanta, etj.. Në takimet e ardhshme do të zgjedhën çështje të rëndësishme për mbarëvajtjen e konferencës.



Foto 2. Grupet punuese të organizimit të konferencës studentore ISCCE 2024, FIN-Tiranë dhe Prishtinë .

Stafi akademik i FIN-it është i sensibilizuar në maksimum për bartjen e përgjegjësisë për konferencën.

Në bazë të deklarimeve të stafit akademik të FIN-it janë disa punime shkencore të punuara brenda vitit 2023 ndër të cilat në tabelën me poshtë janë treguar.

Tabela 16. Punimet shkencore të stafit të FIN gjatë vitit 2023

No .	Author/s	Title of the paper	Journal / Place	Period
1	BERISHA ARBAN	“Solar and Human Activity Impact on High and Low Land River Flows”	CEJ Teheran Vol 9 Nr 7	2023
2	Shkumbin Makolli	A note regarding some fuzzy SSPO mappings /	Konferenca Shkencore: VII Macedonian Mathematical Congress	2023
3	Naser Kabashi, Milot Muhaxheri, Enes Krasniqi, Florentinë Latifi, Ylli Murati	Finite element modelling of retrofitting beam-column joint with FRP <a href="https://www.icce2023.al/wp-content/uploads/2023/05/Programme_ICCE2023.pdf">https://www.icce2023.al/wp-content/uploads/2023/05/Programme_ICCE2023.pdf</a>	ICCE2023 Tirane, Albania	2023
4	Naser Kabashi, Enes Krasniqi, Milot Muhaxheri, Florentinë Latifi, Ylli Murati	SEISMIC BEHAVIOUR OF BEAM-COLUMN JOINT IN R/C FRAMES AND STRENGTHENING WITH FRP <a href="https://crocee.grad.hr/event/2/">https://crocee.grad.hr/event/2/</a>	2CRoCEE, Zagreb , Croatia	2023
5	Valon Veseli, Jelena Ristic, Labeat Misini, Danilo Ristic	SEISMIC PROTECTION OF MASONRY AND INFILLED FRAME BUILDINGS USING UPGRADED SLIDING ISOLATION SYSTEM WITH SF DEVICES <a href="https://crocee.grad.hr/event/2/">https://crocee.grad.hr/event/2/</a>	2CRoCEE, Zagreb , Croatia	2023
6	Valon Veseli Venera Hajdari,	MODELING AND ANALYSIS OF MASONRY STRUCTURES , <a href="http://www.icasem.ibu.edu.mk/publications/">http://www.icasem.ibu.edu.mk/publications/</a> COMBINED PROTECTION OF BRIDGES EXPOSED TO EARTHQUAKE AND FLOOD DISASTERS WITH NEW RB-UPGRADED ISOLATION SYSTEM	2CRoCEE, Zagreb , Croatia	2023
7	Anita Gjukaj, Petar Cvetanoski Ferit Gashi	<a href="https://crocee.grad.hr/event/2/">https://crocee.grad.hr/event/2/</a> THE EFFECT OF COLUMN WEB STIFFENERS ON MOMENT RESISTANCE AND DUCTILITY OF EXTENDED END-PLATE BOLTED CONNECTION	2CRoCEE, Zagreb , Croatia	2023
8	Anita Gjukaj Fidan Salihu, Ali Muriqi, Petar Cvetanovski	Numerical Behavior of Extended Ebd-Plate Bolted Connection under Monotonic Loading <a href="http://dx.doi.org/10.28991/HIJ-2023-04-02-04">http://dx.doi.org/10.28991/HIJ-2023-04-02-04</a>	HighTech and Innovation Journal	2023
9	Anita Gjukaj Petar Cvetanovski, Ana Trombeva	NUMERICAL ANALYSIS OF EXTENDED END-PLATE BOLTED CONNECTION <a href="http://mase.gf.ukim.edu.mk/symposium">http://mase.gf.ukim.edu.mk/symposium</a>	20th International Symposium of MASE	2023

	Gavriloska			
10	F. Ahmedi, P. Thaqi, K. Tosuni	Performance of limestone as a multi-media filter for manganese removal from groundwater <a href="https://doi.org/10.12911/22998993/163251">https://doi.org/10.12911/22998993/163251</a>	Journal of Ecological Engineering	2023
11	F. Ahmedi, Sh. Makolli	Correlation of water quality parameters in Sitnica river in Kosovo over wireless sensors generated dataset	Journal of Water and Land Development	2023
12	A. Rapuca & N. Kopliku	Assessing the UAVs technology for the documentation and preservation of cultural heritage buildings	ICCE2023 Tirane, Albania	2023
13	K. Pavelka, jr, P. Kuzmanov, K. Pavelka & A. Rapuca	DIFFERENT DATA JOINING AS A BASIC MODEL FOR HBIM –A CASE PROJECT ST. PATALEIMON IN SKOPJE	The International Archives of the Photogrammetry, Remote Sensing and Spatial Information Sciences, Volume XLVIII-5/W2-2023, Almaty, Kazakhstan	2023
14	D. Sanchez V. Krasniqi A. Rapuca	AGRO-TOURISM IMPACT ANALYSIS OF CLIMATE CHANGE USING GOOGLE EARTH ENGINE IN THE RAHOVEC WINE REGION OF KOSOVO	The International Archives of the Photogrammetry, Remote Sensing and Spatial Information Sciences, Volume XLVIII-4/W7-2023, FOSS4G, Prizren, Kosovo	2023
15	J. Šušteršič, R. Ercegovič, S. Drolc, N. Kabashi	Polypropylene Fiber Reinforced – Latex Modified Mortar for installation on granite paving blocks on various road sections	<a href="https://icpic23.org/wp-content/uploads/2023/09/program_icpic_2023.pdf">17 th International Congress on Polymers in Concrete ICPIC 2023: Warsaw, Poland</a> <a href="https://icpic23.org/wp-content/uploads/2023/09/program_icpic_2023.pdf">https://icpic23.org/wp-content/uploads/2023/09/program_icpic_2023.pdf</a>	2023
16	Kabashi N. Krasniqi E. Berisha V. Hoti D	<a href="https://cibv.unitbv.ro/images/CIBv2023/Program/02_Program_r5.pdf">Influence of stone dust as replaced material of fine aggregate in concrete properties</a> <a href="https://cibv.unitbv.ro/images/CIBv2023/Program/02_Program_r5.pdf">https://cibv.unitbv.ro/images/CIBv2023/Program/02_Program_r5.pdf</a>	CIBv2023 International Scientific Conference Civil Engineering and Building Services, Braşov,	2023
17	N.Kabashi; E.Krasniqi; M.Muhaxheri	<a href="https://www.irma.si/irma_slo/news.htm">Properties of stone dust and partially replaced of cement in cementitious mortar for repairing</a> <a href="https://www.irma.si/irma_slo/news.htm">https://www.irma.si/irma_slo/news.htm</a>	30 th Slovenian Colloquium on Concrete -ISBN 978-961-93671-9-3 Ljubljana	2023
18	Bajrami Lubishtani, Fitore, Idrizi, Bashkim and Lubishtani, Milot	Determination of the height reference surface for the Republic of Albania by using global geopotential models	<i>Journal of Applied Geodesy</i> , 2023. <a href="https://doi.org/10.1515/jag-2022-0061">https://doi.org/10.1515/jag-2022-0061</a>	2023
19	Bajrami Lubishtani, Fitore, Lubishtani, Milot and Idrizi, Bashkim	COMPUTATION OF THE HEIGHT REFERENCE SURFACE FOR THE TERRITORY OF THE REPUBLIC OF ALBANIA	INTERNATIONAL JOURNAL OF GEOMATE Volume 25, Issue 109 Page 205-212	2023

## 2.2 Raportet e projekteve shkencore

### *Projektet Erasmus+ të FIN-it*

Mbështetur në Strategjinë e miratuar të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit për periudhën 2021-2023 si dhe Strategjisë së FIN 2024-2028, vizioni i njësisë akademike ndër të tjera është i bazuar në Globalizimin dhe Ndërkombëtarizimin “Ndërkombëtarizimi i Fakultetit përmes pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, bashkëpunimi i ndërsjellë me institucionet relevante në projektet hulumtuese, publikimet shkencore në revista kredibile, kongrese dhe konferenca ndërkombëtare”. Në përmbushje të vizionit të Fakultetit dhe të Strategjisë së zhvillimit menaxhmenti, stafi akademik i ndihmuar me administratën organizojnë takime, vizita dhe ngjarje të ndryshme në nivele të vendit dhe ndërkombëtar.

Gjatë këtij viti IAL-ja ka në vazhdueshmëri lidhur me projektet ndërkombëtare të fituara Erasmus + sikur që janë:

- Erasmus + (Key action1) me Trento University, Itali

- Erasmus + (Key action1) me Technology Arts Sciences TH Koln, Gjermani
- Erasmus + University of Poznan, Poloni.
- Erasmus + Mobility for learners and staff, BOKU University Wien.

Si rezultat i projekteve ndërkombëtare të FIN-it janë organizuar punëtori brenda institucionit tonë, jashtë vendit, vizita me karakter pune, trajnime të stafit administrativ si dhe mobilitete të studentëve dhe të stafit akademik.

Memorandum me Trento University është fituar në vitin 2023 dhe është nënshkruar me 17.10.2023 ku parasheh:

1. Mobilitetin e pesë Studenteve nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Trento, në Itali, qëndrim për kohëzgjatje një semestër.
2. Mobilitetin e Stafit Akademik, 4 persona, me qëndrim për kohëzgjatje prej 5 dite pune.
3. Mobilitetin e një Stafit Administrativ të FIN-it për kohëzgjatje prej 5 dite pune.

Memorandumi me BOKU University është fituar në vitin 2023 dhe përfundon në qershor të vitit 2024 ku parasheh:

1. Mobilitetin për Stafin Akademik, prej 60 dite pune. Nga këto ditë, 15 nga personeli Akademik sikur janë: Prof.asst.Dr. Lavdim Osmanaj, MSc. Premton Thaqi dhe MSc. Hana Shehu, kanë qëndruar në IAL nga data 18.06.2023 deri 24.06.2023. Janë edhe pjesa e mbetur e ditëve për mobilitet për të u shfrytëzuar në vitin 2024.

### 2.3 Pjesëmarrjet në konferenca dhe punimet e paraqitura

Konferenca në Zagreb, 22–24 mars 2023, “**The second Croatian Conference on Earthquake Engineering (2CroCEE)**”, planed on the third anniversary of the 2020 Zagreb earthquake, aims to enforce a continuous and decisive “**playing with earthquakes**” in a small and vulnerable country like Croatia. With this conference, we want to establish a new tradition where earthquakes are not forgotten (even if they do not occur very often) and where knowledge is passed on to new generations. In hope of bringing us together again, we invite you to share knowledge, expertise, ideas and experiences that are crucial for the reconstruction process of the earthquake-struck areas, which is a hot topic in Croatia.” Në konferencë morën pjesë stafi akademik i FIN-it Dekani i FIN, Prof.Dr. Naser Kabashi, MSc Valon Veseli, MSc Labeat Misini, MSc Anita Gjukaj, MSc Venera Hajdari duke prezantuar edhe punimet shkencore.

Janë tre ftesa nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë për pjesëmarrje në Simpoziume nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

- Simpoziumi e parë e organizuar në 19 dhjetor të 2022 me temën “Eurocodes and the Structural Safety of Construction Works”, në të cilin rast janë prezantuar dy punime nga FIN me tituj, “Development and Codification of the Earthquake Resistant Design for territory of Kosova” të prezantuar nga Prof.ass.Dr. Florim Grajçevci dhe “Building Materials Used in Construction and testing according the EN” të prezantuar nga Prof.Dr. Naser Kabashi
- Simpoziumi i dytë e organizuar në 21 qershor 2023 me temën “Pasuritë Ujore – Platformë gjithëpërfshirëse për sektorin e ujërave”, në të cilin rast është prezantuar punimi “Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë” të prezantuar nga Prof.asst.Dr. Florim Grajçevci.

- Simpoziumi i tretë në të cilën ishte edhe FIN, pjesë organizative e punëtorisë e organizuar e datë 15 dhjetor 2023, me temën “Design Codes of Dams and their Seismic Safety” është presantuar punimi me titull “Assessment of the current situation of the material properties Stability and Dams sustainability – Study case of the Mirusha Damp, Malisheve, Kosovë” të prezantuar nga Prof.asst.Dr. Florim Grajçevci.

Konferenca “The Macedonian Association of Structural Engineers (MASE) hosted the 20th MASE International Symposium on Resilient Structures in Skopje from 28-29 September 2023” në të cilën morrën pjesë disa nga stafi akademik.

Prof.asst.Dr.Milot Muhaxheri gjatë periudhës prill deri në korrik 2023, ka qenë përfitues i grantit nga HERAS+, i mbështetur nga Austrian Development Cooperation, për realizimin e një vizite post-doktorale në TU Wien në Institutin e Materialeve të Ndërtimit dhe Teknologjisë së Ndërtimit. Kjo vizitë është udhëhequr nga prof.Agathe Robisson, ku ka kryer pjesë eksperimentale rreth zhvillimit të çimentos me përdorimin e mbetjeve të pluhurit të produkteve argjilore.

### **3. AKTIVITETE TË NDRYSHME TË FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT**

Inventarizimi i sallave të mësimit me pajisje të konkretizimit, “Smart board” TV, tabela mësimi etj. është karakterizuese për këtë periudhë raporti, secila klasë mësimi posedon video projektorin ndërsa klasat e mësimit në katin e parë ( platforma 500) si dhe amfiteatri 415 janë pajisur me TV smard board.

Si rezultat i marrëveshjes në mes të SKAT dhe UP, përkatësisht FIN-it, është pasuruar me pajisje Laboratori i Hidroteknikës dhe Inxhinierisë së ambientit, ndërsa ka përfunduar pjesa e parë e liferimit të pajisjeve janë zhvilluar procedurat e tenderimit për pajisje të laboratorit të Strukturave dhe është nënshkruar kontrata e cila do të përmbushet në vitin 2023.

Gjatë semestrit veror janë realizuar shumë vizita studimore me studentët nga mësimdhënësit në objekte dhe lokacione brenda Kosovës dhe kryesisht në Shqipëri.

Fakulteti ndanë mirënjohje për studentët e dalluar për çdo vit akademik. Edhe këtë vit janë shpallur 22 studentët më të mirë sipas kriterëve: nota mesatare më e lartë (mbi notën 9) nga të gjitha programet e studimeve. Për këta studentë, shënimet e tyre janë publikuar në faqen elektronike të Fakultetit.

Në mënyrë të rregullt, menaxhmenti i FIN-it organizon takime me studentët si dhe me këshillin e studentëve të FIN-it duke identifikuar prioritetet, nevojat si dhe kërkesat e tyre.

Administrata e Fakultetit është angazhuar në maksimum për punët e përditshme si dhe në raste edhe për punët e shtuara në varësi të nevojave të fakultetit sikur ishin organizimet e shumta që u bënë brenda vitit 2023 (ligjëratat e Hapura, konferenca ICCE, manifestimi i ditës botërore të ujit, takime sociale dhe shoqërore në Tiranë dhe Prishtinë).

#### **3.1 Staf i akademik i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit**

Stafi Akademik i rregullt, është aktiv në avancime me grada shkencore dhe tituj akademik. Njësia jonë akademike hulumton edhe tregun e punës për krijimin e mundësive të reja me kuadro profesionale dhe aktualisht mendohet edhe për krijimin e programeve të reja të studimeve.

Duke pas parasysh lëvizjet e stafit akademik, avancimet, pensionimet, mundësitë e projekteve të reja për programe të studimeve Fakulteti është i detyruar të riorganizohet në vazhdimësi në mënyrë që të arrihet cilësia sa më e lartë e studimeve dhe njëkohësisht të mendohet edhe në projektet e ardhshme.

Nga janari deri në qershor të vitit 2023, numri i stafit akademik me kontratë të rregullt 34, nga të cilët 17 janë mësimdhënës ndërsa 17 janë asistent.

Lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e stafit akademik të Fakultetit, në nivel të Universitetit është zhvilluar dhe ka përfunduar konkursi i rregullt me të cilin janë avancuar: katër mësimdhënës nga asistent në profesor asistent, një mësimdhënës nga Profesor i asocuar në Profesor.Dr. dhe tre asistentë të rregullt. Ky konkurs ka përmbajtur edhe ripërtëritjen e stafit akademik me riemërimin në pozita të njëjta për stafin akademik.

Pas zhvillimit të konkursit për emërimin, riemërimin dhe avancimin e stafit akademik në vitin 2023 në kuadër të stafit akademik të FIN-it, janë realizuar këto avancime nga asistent në profesor asistent:

Tabela 17, avancimet e stafit akademik të FIN, nga asistent në Prof.asistent.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike paraprake	Avancimi në gradën Akademike
1.	Arban Berisha	Asistent i rregullt	Profesor asistent Dr.
2.	Fitore Bajrami	Asistent i rregullt	Profesor asistent Dr.
3.	Fidan Salihu	Asistent i rregullt	Profesor asistent Dr.
4.	Besim Ajvazi	Asistent i rregullt	Profesor asistent Dr.

Avancimet nga Prof.asoc.Dr. në Profesor.Dr.:

Tabela 18, avancimet e stafit akademik të FIN, nga Prof.asoc në Prof.Dr.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike paraprake	Avancimi në gradën Akademike
1.	Figene Ahmedi	Prof.asoc.Dr.	Profesor Dr.

Emërimet për herën e parë në asistent i rregullt:

Tabela 19, emërimet e stafit akademik për herën e parë në FIN.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike
1.	Vlerë Krasniqi	Asistent i rregullt
2.	Almedina Rapuca	Asistent i rregullt
3.	Ilir Cani	Asistent i rregullt




Figura 16. Stafit akademik i rregullt i FIN - 2023

Numri i përgjithshëm i stafit të rregullt të FIN-it në vitin 2023, për vitin akademik 2023/2024 është 37.

Stafi akademik i angazhuar në FIN për vitin akademik 2023/2024 sipas konkursit të zhvilluar dhe procedurave të përfunduara nga këshilli i FIN janë sipas këtyre statistikave:

Tabela 20, Stafit akademik i angazhuar sipas konkursit në FIN për vitin akademik 2023/2024.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike
1.	Ardian Kadiri	Asistent bashkëpunëtor
2.	Armend Mujaj	Asistent bashkëpunëtor
3.	Festina Sadiku	Asistent bashkëpunëtor
4.	Fisnik Loshi	Asistent bashkëpunëtor
5.	Liron Morina	Asistent bashkëpunëtor
6.	Milaim Sylka	Asistent bashkëpunëtor
7.	Valon Azizi	Asistent bashkëpunëtor
8.	Ylli Murati	Asistent bashkëpunëtor
9.	Ardita Ibishi	Lektore
10.	Ilir Rodiqi	Mësimdhënës
11.	Islam Fejza	Mësimdhënës
12.	Ismajl Kabashi	Mësimdhënës

Tabela 21, Stafit akademik i pensionuar i angazhuar në FIN për vitin akademik 2023/2024.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike
1.	Fevzi Berisha	Mësimdhënës
2.	Abdullah Zejnullahu	Mësimdhënës
3.	Misin Misini	Mësimdhënës

Tabela 22, Stafit akademik i angazhuar nga njësitë tjera të Universitetit të Prishtinës në FIN për vitin akademik 2023/2024.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike	Njësia Akademike e UP-së
1.	Arta Basha Jakupi	Mësimdhënës	FA
2.	Violeta Nushi	Mësimdhënës	FA
3.	Mimoza Dugolli	Mësimdhënës	FA
4.	Dukagjin Hasimja	Mësimdhënës	FA
5.	Dashnor Kadiri	Asistent	FA
6.	Rrona Berisha	Asistent	FA
7.	Kaltrina Spahiu	Asistent	FA
8.	Bekim Gashi	Mësimdhënës	FSHMN
9.	Bukurije Hoxha	Asistent	FIM
10.	Rexhep Selimaj	Mësimdhënës	FIM
11.	Jeton Halili	Mësimdhënës	FSHMN
12.	Halil Ibrahim	Mësimdhënës	FSHMN
13.	Idriz Vehapi	Mësimdhënës	FSHMN
14.	Naim Jerliu	Mësimdhënës	FM
15.	Sefer Avdijaj	Mësimdhënës	FSHMN
16.	Zeqë Tolaj	Asistent	FSHMN

Tabela 23, Stafit akademik Profesor Vizitor i angazhuar në FIN për vitin akademik 2023/2024.

nr	Emri dhe Mbiemri	Thirrja akademike	IAL-ja
1.	Neritan Shkodrani	Mësimdhënës	FIN - UPT, Shqipëri
2.	Oltion Marko	Mësimdhënës	FIN – UPT, Shqipëri
3.	Lars Ribe	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani

4.	Sudeh Dejnavi	Mësimdhënës	FA – Koln, Gjermani
5.	Xhesik Hoxha	Hulumtuëse shkencore	FA – Koln, Gjermani
6.	Vlado Spiridonov	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV
7.	Cvetanka Popovska	Mësimdhënës	K&M, Shkup, RMV
8.	Mimoza Hyseni Spahiu	Mësimdhënës	UP, Haxhi Zeka, Pejë

Gjithsej numri i përgjithshëm i stafit akademik të përfshirë në procesin mësimor në FIN për vitin akademik 2023/2024 është 76. Si rezultat krahasimi për raportin e numrit të studentëve për një mësimdhënës është  $1159/76 = 15.26$  student për mësimdhënës.



Figura 17. Stafi akademik i angazhuar i jashtëm dhe vizitor për 2023/2024

Stafi akademik i angazhuar me kontratë (F3), sipas konkursit, për vitin akademik 2023/2024 janë 12 mësimdhënës.

### 3.2 Aktivitetet sociale të FIN-it

Brenda vitit kalendarik janë zhvilluar aktivitete akademike të shumta brenda Institucionit me qëllime të rritjes së bashkëpunimeve kolegjalë, rritjes së cilësisë së mësimdhënies si dhe afërsia me studentët. Aktivitetet janë të natyrave nga më të ndryshmet dhe janë zhvilluar gjatë gjithë vitit.

Nga në maj 2023, janë organizuar “Ditët e Hapura” nga Fakulteti i Ndërtimtarisë me stafin akademik i mbështetur nga stafi administrativ, duke organizuar vizita në shkollat e mesme të Kosovës me qëllim sensibilizimin e tyre rreth IAL-së, programeve të studimeve brenda njësisë tonë akademike si dhe veprimtarive shkencore e hulumtuëse. Për organizimin e “ditëve të hapura”, janë formuar disa grupe punuese të përbëra nga stafi akademik të cilët kanë vizituar disa shkolla të mesme në vendbanimet e Kosovës. Gjatë vizitës janë shpërndarë broshura të Fakultetit me përmbajtje të njoftimeve të sintetizuara për fakultetin. Konsiderohet se kjo fushatë e organizuar nga menaxhmenti, stafi akademik i fakultetit, mbështetur nga administrata është ngjarje sociale e karakterizuar me një unifikim të madh dhe se ka sensibilizuar rininë e vendit si dhe ka siguruar një prurje të studentëve të riinjë.



Me qëllim rritjen e bashkëpunimit të IAL-së me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës është organizuar takim pune i përbashkët i dy Institucioneve në Tiranë nga data 06 deri 09 tetor. Takimet janë realizuar në Tiranë, në ambientet e Fakultetit dhe ishin me produktivitet që bashkëpunimet të vazhdonin në shumë fusha.

Brenda vitit janë organizuar shumë takime të brendshme të menaxhmentit me grupe të ndryshme punuese të stafit akademik duke shtjelluar tema dhe aktualitete të rëndësishme për Institucionin si dhe takime me administratën e Fakultetit.

Me qëllim përmbylljen e vitit kalendarik menaxhmenti, stafi akademik së bashku me administratën organizojnë mbrëmjen festive duke kontribuar në socializmin dhe mbështetjen, përkrahjen e njëri tjetrit.

### **3.3 Aktivitetet akademike në bashkëpunim me tregun e punës të FIN-it**

Bordi Industrial i Fakultetit brenda vitit ka organizuar shumë takime me karakter pune. Gjatë gjithë punës një vjeçare Bordi i Fakultetit ka mbështetur njësinë tonë dhe studentët duke ju ofruar punë praktike në ndërmarrjet vendore si dhe në organizimin e ligjëratave të hapura duke siguruar edhe përkrahje financiare.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me traditën e vet institucionale, duke promovuar punën hulumtuese, praktikën e rasteve studimore, projektet e veçanta të niveleve kombëtare dhe ndërkombëtare organizon ligjëratat të hapura me tema të ndryshme nga fushat inxhinierike sikur janë Strukturat, Hidroteknika, Gjeodezia, Inxhinieria e Ambientit, të cilat lidhen me analiza shkencore, studime të projekteve, raste studimore, çështje të efekteve ambientale dhe sociale.

Qëllimi i Organizimit të ligjëratave të Hapura brenda FIN-it për studentët, stafin akademik dhe tregun e punës është sensibilizimi me të arriturat shkencore, vështirësitë, sfidat dhe praktikën për realizimin e studimeve, projekteve dhe ndërtimeve për raste konkrete, zbërthimi i problemeve shkencore dhe të tjera.

Janë një numër i konsideruar i organizimit dhe mbajtjes së ligjëratave të hapura në Fakultetin tonë me prezantues eminent vendor dhe nga Institucionet e jashtme Evropiane. Sipas agjendës së shpallur në kohë të mbajtjes së ligjëratave të hapura brenda vitit numërohen:

- 27 Janar 2023, prezantues Prof. Mathias Worst, Manager Technology Transfer Water Project at Administration, Watermanagement Agency, me titull “Water management in Bavaria tasks, responsibilities, structure, legal framework and challenges ahead”.
- 21 - 29 Mars 2023, prezantuesit Prof. Florian Kretschmer, Universiti BOKU, Vienë. Austri me temën “Wastewater as a Resource”.
- Ligjeratë e hapur - Prof.Dal Lago Bruno, “Strukturat e parapergaditura-Zhvillimi teknologjik, 12.04.2023
- Ligjeratë e hapur - Prof.Dr. Niko Pojani, “Aspekte te perdorimit te tenzoreve dhe matricave ne Mekaniken e materialeve”, 27.04.2023
- Ligjeratë e hapur - Dr. Alessandro Bianciardi, “Dizajni I frymezuar biologjikisht per inovacion”, 10.05.2023,
- Ligjeratë e hapur - BIM-i për inxhinierët - Matjaž Šajn, “BIM-I per inxhinieret”, 30.05.2023

- Ligjeratë e hapur - Bujar Morava, “Vleresimi i sjelljes se strukturave ndaj ngarkesave tee res nepermjet testimi ne tunelet e eres”, 08.06.2023,
- Ligjeratë e hapur - Bruno Dal Lago, “Sustainability and structures”, 26.10.2023,
- Ligjeratë e hapur - Dr. Thomas Ertl, “Societal role of universities in integrated water management through research, education and training”, 30.10.2023,
- Ligjeratë e hapur - Dr. Dorina Pojani, “Human and Vehicles, A love story”, 11.12.2023,  
<https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,37>.

Të gjitha ligjeratat e Hapura të organizuara ishin të përcjellur nga stafi akademik dhe studentët e Fakultetit pa përjashtuar edhe audiencën e jashtme që ishin prezent në shumë prej ligjeratave.

### **3.4 Bashkëpunimet në nivel vendi të FIN-it, vizitat, punëtoritë, aktivitete akademike te organizuara.**

Si nevojë e zhvillimit të IAL-së, me shumë institucione të vendit u arritën marrëveshje të cilat kishin qëllim krijimin e mundësive të zhvillimit të praktikave për studentët. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit po ashtu ka arritur bashkëpunime me kompani, institucione dhe organizata të sektorit publik dhe privat me të cilët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në nivel të UP-ës dhe FIN (shih vegëzën: <https://fin.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,56>). Këto bashkëpunime synojnë në përmbushjen e kërkesave konform rritjes së nivelit kërkimor dhe profesional. Disa nga marrëveshjet bashkëpunuese (të tri viteve të fundit, por jo vetëm), nga të cilat përfitojnë studentët e programeve të studimeve të FIN-it për punë praktike dhe përfitime kërkimore e profesionale..

- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovë 11.11.2021.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Kompanisë GM Arkitekturë, 11.11.2021.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe kompanisë Maluku Grup, 11.11.2021.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave Ministria e Punëve të Brendshme-MPB, 11.11.2021.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Geo Koha "SH.P.K, 11.11.2021.
- Memorandum Mirëkuptimi në mes të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe AGEO& CO Sh.p.k. 11.11.2021.
- Memorandum i lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” –Fakulteti i Ndërtimitarisë. 08.03.2022.
- Memorandum mirëkuptimi në mes-Fakultetit të Ndërtimitarisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit dhe Mekanik, Universiteti i Shkencave të Jetës në Poznan, Poloni, 22.03.2022.
- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Prizren dhe Fakultetit të Ndërtimitarisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” 25.03.2022.
- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica” dhe Fakultetit të Ndërtimitarisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” 28 03.2022.

- Memorandumi i Bashkëpunimit i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit të Ndërtimtarisë lidhur me vlerësimin e gjendjes fizike të ndërtesave të dëmtuara në kuadër të kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz. 28 qershor 2021.
- Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht ndërmjet Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe KRU “PRISHTINA” (Kompania regjionale e ujësjellësit), datë 02 Mars 2021.
- Erasmus+, Mobility for Learners and Staff, Higher Education Student and Staff Mobility. Inter-Institutional agreement 2020-23, between Institutions from Programme and Partner Countries, Università degli Studi di Trento/Italia and University of Pristina. Signed on date 02 March 2021.[T3].
- Marrëveshja ne mes te Universitetit te Prishtinës, përkatësisht njërive akademike, Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetit te Shkencave Matematikore dhe Natyrore për zbatimin e grantit për hulumtim për "Monitorim të cilësisë së ujerave dhe monitorim te ujit te puseve ne pjesën perëndimore të komunës së Lipjanit, 06.03.2023.
- Punëtorja - "Metodat Bashkëkohore të Mësimdhënies dhe Vlerësimit të Vazhdueshëm të Studentëve" Prof. Majlinda zhitija Gjellaj, 4.10.2023.
- Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universitetit të Prishtinës, me SKAT, 4.12.2023.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe NPH “IBER LEPENCI”, 08.12.2023.
- Me 13 Dhjetor 2023, në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Ndërmarrjen Publike Banesore ne Prishtinë.

Nga marrëveshjet e realizuara janë më shumë se 30 studentë që kanë zhvilluar praktika profesionale në shumë raste me mbështetje financiare. Në disa nga marrëveshjet Fakulteti me grupe të formuara punuese në përbërje staf akademik dhe student janë angazhuar për verifikim të kapaciteteve të objekteve ekzistuese, vlerësimin e tyre nga rreziku i mundur për shfrytëzim të objekteve etj.

Janë zhvilluar shumë vizita të objekteve ekzistuese dhe që janë në ndërtim, impianteve ekzistuese të ujit të pijes, pastrimit të ujërave fabrikave ndërtimore etj. në Kosovë dhe në Shqipëri.

Gjatë vitit 2023 u organizuan takime pune të shumta në mes të FIN,UP dhe FIN,UPT. Në mars, maj, tetor, dhjetor 2023 ishin takime të ndërsjellta në Tiranë dhe Prishtinë të organizuara ndërmjet dy IAL-ve, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit.

Janë shumë lëndë gjygjësore për të cilat është kërkuar nga Fakulteti të krijohen ekspertiza nga mësimdhënësit.

### 3.5 Aspekte financiare në FIN:

Tabela e zërave buxhetor të shpenzuara në vitin 2023

Zëri buxhetor	Shuma	Përshkrimi
Organizimi i konferencës shkencore ICCE2023	16,500.00 €	Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit dhe shpenzime tjera të konferencës së përbashkët shkencore në mes të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Fakultetit të Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës, e planifikuar në maj 2023 në Tiranë.
Realizimi dhe ndërtimi i këndit ndërkombëtar	3,000.00 €	Kërkesë e rektoratit që të kemi një kënd ndërkombëtar për fakultetin e FIN-së

Shërbime teknike	400.00 €	Fushata ditët e hapura, organizimi i vizitave në shkollat e mesme të Kosovës për njoftimin e maturantëve për të studiuar në programet e studimeve në FIN, përgatitja e postereve, fletëpalosjeve, video promovuese, udhëtimet....
Furnizim për zyre	1,000.00 €	Furnizim për zyre. Gjatë vitit 2023, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka nevojë për furnizim me: karrige, tavolina, dollapë, për zyrat e fakultetit (sekretari, prodekanët, referentët, administrata dhe kabinetet)
Furnizim me ushqim dhe pije	1,000.00 €	Organizimi i pritjes së delegacioneve nga universitetet evropiane dhe të rajonit, ushqime të shpejta (barby quie), pije në ambientet e fakultetit. Në raste të tilla promovimi i IAL-ve përmes kontakteve direkte me studentët, stafin akademik dhe administratën.
Patty Cash	250.00 €	Avance për para të imëta.
Darka e fundvitit e stafit të fakultetit të FIN-it	2,000.00 €	Darka e fundvitit e komplet stafit akademik dhe administrativ të FIN-së
<b>Mjete të konkretizimit</b>	20,000.00 €	Smart Board për pajisjen e klasave të mësimt, softuer dhe server për nevojat e studentëve. Kompjuterë, laptop dhe mjete tjera të konkretizimit.
<b>Pajisje laboratorike</b>	250,000.00 €	Pajisje për labororët e konstruksioneve, materialeve, asfaltit, gjeomekanikës, hidroteknikës, gjeodezisë dhe inxhinierisë së ambientit.
		Një pjesë e pajisjeve të labororit të konstruksioneve, e kontraktuar në vitin 2022 në vlerë prej 150.000,00€ si dhe 25.000,00€ nga buxheti i vitit 2023.
Servisimi – kalibrimi i pajisjeve ekzistuese.		Servisimi – kalibrimi i pajisjeve ekzistuese.
Renovimi I kulmit	295,150.00 €	Renovimi I kulmit dhe pjesëve tjera
		Totali: 295, 150.00€+ servisimi i pajisjeve laboratorike + kulmi

- Realizimi i kontratës së renovimit të objektit të Fakultetit, Kulmi. Buxheti është i përbashkët nga tri fakultetet teknike (FIN, FIEK dhe FIM) në vlerë rreth 295,150.00€ Projekti është ë i finalizuar në dhjetor të vitit 2023.
- Janë zhvilluar procedurat e tenderimit dhe është nënshkruar kontrata për pajisjet laboratorike të strukturave në vlerë 175,000.00€ Realizimi i furnizimit me pajisje është realizuar në dhjetor 2023.
- Laboratori i Hidroteknikës përkatësisht Inxhinierisë së Ambientit i fituar nga FIN për programin e studimeve MSc në MIRU (IWRM) për rinovimin e hapësirave dhe i pajisur me pajisje për nevojat e studentëve salla me kompjuter në vlerë rreth 205,000.00€
- Ka filluar hartimi i projektit për rinovimin e katit të pestë. Sallat e mësimt, korridoret, hapësirat tjera përcjellëse të cilat duhet të trajtohen duke realizuar një projekt shumë ambicioz.
- Donacione për FIN nga kompanitë vendore, organizimi i konferencës ICCE2023 në shumë 12,000.00€ materiale konkretizimi, qasje në platforma elektronike për nevojat e gjeodezisë, shërbime të ndryshme në printime, transporte, shërbime teknike – dyer, ngjyrosje etj.

### 3.6 Puna e FIN me palën e tretë

Stafi akademik i FIN-it ka qenë i angazhuar në shërbime profesionale për palën e tretë, përkatësisht institucioneve gjyqësore të Kosovës duke bërë vlerësime dhe ekspertiza

profesionale. Shërbime profesionale për Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, vlerësimi i objekteve të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit,  
Prof.ass.Dr. Florim Grajçevci